



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E LËNDËS SË HISTORISË NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Material në ndihmë të mësuesit

2023

Koordinoi hartimin e udhëzuesit

Ines Todhe, ASCAP

Koordinoi redaktimin shkencor

Dr. Gerti Janaqi

Dr. Dorina Rapti

Koordinoi redaktimi letrar

Miranda Kurti

Koordinoi faqosjen

Eriksen Mersinllari

Prodhim i ASCAP, 2023

www.ascap.edu.al

Copyright ©, ASCAP

TABELA E PËRMBAJTJES

I. QËLLIMI I UDHËZUESIT TË LËNDËS SË HISTORISË	5
1.1 Qëllimi i udhëzuesit.....	5
1.2 Përdoruesit e udhëzuesit.....	5
1.3 Struktura e udhëzuesit	5
II. RËNDËSIA E LËNDËS SË HISTORISË NË ARSIMIN E MESEM TË LARTË	6
2.1 Synimet e mësimdhënies dhe të nxënit në lëndën e historisë	6
2.2 Risitë e lëndës së historisë	8
2.3. Shtrirja e lëndës së historisë në Arsimin e Mesëm të Lartë.....	11
III. MODELE TË ZHVILLIMIT TË KOMPETENCAVE KYÇE NËPËRMJET KOMPETENCAVE TË LËNDËS	12
IV. INTEGRIMI NDËRLËNDOR	19
V. TEMAT NDËRKURRIKULARE.....	24
VI. METODOLOGJIA PËR ZHVILLIMIN E LËNDËS	29
VII.PLANIFIKIMI I LËNDËS DHE MODELE TË PLANIFIKIMIT LËNDOR.....	41
7.1. Llojet e planifikimeve	41
7.2. Planifikimi vjetor i lëndës	42
7.3. Model planifikimi vjetor	43
7.4 Planifikimi i periudhës	45
7.5. Model planifikimi për një periudhë	47
7.6. Planifikimi ditor	49
7.7. Model i planifikimit të orës mësimore	49
VIII. VLERËSIMI I NXËNËSVE NË LËNDËN E HISTORISË.....	67

8.1. Vlerësimi i vazhduar (për të nxënë)	68
8.2. Vlerësimi i të nxënit (test/detyrë përmbledhës)	69
8.3. Projekti	70
8.3.1 Vlerësimi me projekt kurrikular	70
8.3.2 Planifikimi i projektit	70
8.3.3 Stadet kryesore që ndiqen për realizimin e një projekti janë:	71
8.3.4 Rubrikat kryesore të planit të një projekti kurrikular përfshijnë:	71
8.3.5 Projekti kurrikular vjetor	75
<i>Qasja kërkimore nëpërmjet punës me projekte</i>	75
8.3.6 Model projekti në lëndën e historisë	77
8.4 Vlerësimi i të nxënit të nxënësit realizohet nëpërmjet:	83
8.4.1 Vlerësimi periodik	83
8.4.2 Vlerësimi përfundimtar	83
8.6 Nivelet e arritjeve	85
8.7 Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësit nga nxënësi	86
IX. KRITERET E HARTIMIT DHE TË VLERËSIMIT TË TESTIT	88
9.1 Parimet e hartimit të testeve nga mësuesi	88
9.2 Hartimi i testit	89
9.3 Llojet e pyetjeve që hartohen në teste	92
9.4 Detyra përmbledhëse	106

I. QËLLIMI I UDHËZUESIT TË LËNDËS SË HISTORISË

1.1 Qëllimi i udhëzuesit

Udhëzuesi lëndor i lëndës së historisë për arsimin e mesëm të lartë, trajton në mënyrë më të thellë të gjitha aspektet e kurrikulës që nga planifikimi i saj, metoda të mësimdhënies, metoda të të nxënësve, vlerësimin e nxënësit në kontekstin e zhvillimit të kompetencave gjatë zbatimit të programeve të historisë klasa 10-12. Në këtë udhëzues janë kombinuar materiale për zbatim e kurrikulës me kompetenca nga eksperiencia dhe praktikat më të mira të mësuesve në shkollë. Ky udhëzues synon të nxisë kreativitetin e mësuesve për të përdorur metoda mësimdhënie-nxënie sa më interesante dhe tërheqëse për nxënësin, që lehtësojnë procesin e nxënies në lëndën e historisë.

1.2 Përdoruesit e udhëzuesit

Udhëzuesi u vjen në ndihmë punonjësve arsimorë në sistemin e arsimit parauniversitar dhe si i tillë përdoret:

- nga mësuesit, drejtuesit e shkollave, nxënësit, prindërit të cilët punojnë së bashku për të përmirësuar cilësinë e të nxënësve dhe rezultateve të nxënësve në lëndën e historisë.
- nga të gjitha institucionet arsimore në varësi të MAS, njësitë arsimore vendore për zhvillimin profesional, këshillimin, vëzhgimin, monitorimin, kualifikimin e punonjësve arsimorë.
- nga institucionet e arsimit të lartë që përgatisin mësues në lëndën e historisë, të cilët mund t'i referohen për formimin fillestar të mësuesve të rinj.

1.3 Struktura e udhëzuesit

Udhëzuesi mundohet të japë përgjigje për një sërë pyetjesh dhe çështjesh të ngritura nga drejtuesit e shkollës, mësuesit, nxënësit, prindërit të cilët herë pas here kanë dilemat e tyre në lidhje me zbatimin e kurrikulës me kompetenca në lëndën e historisë. Pjesë e udhëzuesit, përveç aspekteve të planifikimit të kurrikulës, teknikave të vlerësimit të realizimit të kompetencave, kritereve të hartimit dhe vlerësimit të testit, kritereve për hartimin dhe zbatimin e projektit, janë edhe modele/shembuj¹:

- të zhvillimit të kompetencave kyçe nëpërmjet kompetencave të lëndës;

¹Shënim: Shembujt/modelet e dhëna në udhëzues janë dhënë për qëllime ilustrimi dhe nuk janë ezaurues (shterues).

- të integritimit ndërlëndor brenda dhe jashtë fushës së të nxënit;
- të përdorimit të metodave, teknikave dhe strategjive që përdoren për zhvillimin e kompetencave të lëndës dhe kyçe;
- të planifikimit kurrikular të lëndës;
- të planifikimit të projektit kurrikular;
- të hartimit dhe vlerësimit të testit.

II. RËNDËSIA E LËNDËS SË HISTORISË NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Lënda e historisë është thelbësore në zhvillimin e qytetarëve, të cilët i kuptojnë çështjet aktuale me zgjuars, nëpërmjet kuptimit, analizës dhe përfundimeve të nxjerra nga përvojat e së shkuarës. Studimi i lëndës së historisë i ndihmon nxënësit të zhvillojnë një ndjenjë humanizmi të gjerë, të kuptojnë zhvillimin e personalitetit të tyre, mënyrën si ata ngjasojnë dhe diferencohen nga të tjerët në raport me kohën dhe me hapësirën, të dallojnë diferencën midis supozimit dhe faktit, të mos besojnë në përgjigjen e paargumentuar dhe të respektojnë vërtetësinë e burimeve historike, duke dalluar analogjinë false, të njohin abuzimet nga “mësimet” historike, të peshojnë pasojat që vijnë prej tyre, si dhe të marrin parasysh se padija për të shkuarën na bën “të burgosurit” e saj. Detyra e historisë është të drejtojë nxënësit për t’u bërë pjesëtarë të përgjegjshëm të shoqërisë, të cilët dinë se si të trajtojnë në mënyrë kritike një fenomen të epokës së tyre dhe të së shkuarës.

2.1 Synimet e mësimdhënies dhe të nxënit në lëndën e historisë

Historia i ndihmon nxënësit të kuptojnë botën duke kërkuar në rrënjët e shkuara të saj. Ajo kontribuon në zhvillimin e një perspektive globale dhe kuptimi të zgjeruar të proceseve të ndërveprimit, diversifikimit dhe ndryshimit të shpejtë të botës së sotme.

Studimi i kësaj lënde në arsimin e mesëm të lartë synon të nxisë interesin e nxënësve duke u dhënë atyre një mundësi për të ndjekur një cikël mësim-nxënie që kapërcen kufijtë kohorë, kulturorë dhe politikë të botës sonë.

Kurrikula e historisë në arsimin e mesëm të lartë i ndihmon nxënësit që të bëhen të ditur, të logjikshëm, kureshtarë, të balancuar, të ndjeshëm dhe individë të aftë për të dhënë argumente dhe vendime të arsyetuara mirë.

Historia ndërton tek nxënësi konceptet, kompetencat dhe cilësitë historike, nëpërmjet:

- angazhimit në mënyrë aktive në kërkimin historik me qëllim që të zhvillojë vetëbesimin, reflektimin dhe mendimin kritik;

- zhvillimit të aftësive/shkathtësive të kërkimit historik, duke u bazuar në burime historike për studimin e ngjarjeve të ndryshme të historisë;
- interpretimit të efektit të kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në marrëdhëniet historike dhe rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes;
- interpretimit të historisë së shoqërisë njerëzore në të kaluarën, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë të sotmen;
- kuptimit se si dhe pse ngjarje dhe çështje të veçanta historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme;
- zhvillimit të aftësive për të analizuar dhe për të interpretuar informacionin historik në mënyrë kritike dhe të përgjegjshme, nëpërmjet dialogut, kërkimit të së vërtetës dhe përmes debatit të hapur, sidomos për çështje të ndjeshme historike;
- ndërveprimet me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme për të njohur të kaluarën dhe për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike;
- mundësimin të ndërtimit të identitetit individual dhe kolektiv përmes njohjes dhe krahasimit të trashëgimisë së tyre historike të përbashkët;
- vlerësimin të pozitës së qytetërimit shqiptar në raport me qytetërimet botërore;
- argumentimin të vlerave të trashëgimisë historike, duke e vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë të përcaktimit të identitetit të një populli;
- përdorimin të ICT për të kërkuar informacion për të shkuarën në lidhje me datat, personazhet, objektet, ngjarjet dhe proceset historike, si dhe për të përzgjedhur, klasifikuar, organizuar dhe paraqitur gjetjet;
- zhvillimit të aftësive qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri;
- ndërtimit të aftësive për të kuptuar, organizuar dhe komunikuar dijet e tyre historike përmes mënyrave të ndryshme dhe përdorimit të mediave të ndryshme;
- pajisjes me kompetencat e duhura për të kontribuar në mënyrë aktive dhe me përgjegjësi si qytetarë lokalë dhe globalë në ndërtimin e perspektivës;
- forcimin të ndjenjës së identitetit kombëtar dhe të respektit për historinë kombëtare, me qëllim zgjerimin e përmasave evropiane në studimin e historisë.

Me përfundimin e ciklit 3-vjeçar të studimit të historisë në shkollën e mesme, nxënësit përvetësojnë aftësi të rëndësishme si kërkimi, përdorimi i burimeve, analiza dhe interpretimi

historik, gjë e cila i lejon ata të vlerësojnë historinë e vendin të tyre në rrjedhën e gjatë të historisë njerëzore.

2.2 Risitë e lëndës së historisë

Trajtimi i lëndës së historisë nëpërmjet koncepteve kyçe dhe kompetencave është risia kryesore e lëndës së historisë.

- Programi i historisë, nëpërmjet të gjitha tematikave që zhvillon, ndërton një numër kompetencash dhe konceptesh, të cilat mbështesin studimin e historisë. Kompetencat historike janë procese dhe aftësi thelbësore që përfshihen në të gjithë programin e historisë nëpërmjet tematikave dhe situatave të sugjeruara.

Kompetencat dhe konceptet e lëndës së historisë janë:

Kompetenca historike:

1. kërkimi historik;
2. përdorimi i burimeve;
3. analiza shkak – pasojë;
4. interpretimi historik;
5. shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën

Koncepte kyçe historike:

1. kuptimi kronologjik;
2. ndryshimi dhe vazhdimësia;
3. shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare;
4. rëndësia.

Kurrikula e historisë është strukturuar në zhvillimin e ndërtimit të pesë kompetencave historike, të cilat janë dhënë në tabelën më poshtë. Organizimi i mësimi të historisë me bazë kompetencat, siguron zhvendosjen e fokusit të nxënies nga përmbajtja lëndore (mësuesi në qendër) në atë që nxënësit kanë nevojë të dinë dhe të bëjnë me efikasitet në situata të ndryshme të nxëni (nxënësi në qendër). Nxënësit mësojnë nga njerëzit dhe situatat rreth tyre.

Tabela: Kompetencat historike

Kompetenca	Treguesit
<i>Kompetenca: Kërkimi historik</i> Kjo kompetencë ka të bëjë me shtrimin dhe hartimin e pyetjeve për çështje historike, për të strukturuar një shqyrtim, për të përzgjedhur burimet, për të dhënë fakte për të nxjerrë dhe për të argumentuar konkluzionet.	<i>Disa tregues kryesorë janë:</i> - Kërkon, zbulon, identifikon dhe shqyrton, individualisht dhe si pjesë e një grupi, pyetje specifike historike ose çështje, duke bërë testimin e hipotezave; - reflekton në mënyrë kritike për pyetje ose çështje historike.
<i>Kompetenca: Përdorimi i burimeve</i> Kjo kompetencë ka të bëjë me vlefshmërinë dhe me besueshmërinë e burimeve historike të përdorura.	<i>Disa tregues kryesorë janë:</i> - shpjegon tipet e burimeve historike, si një domosdoshmëri në punën e historianit; - kërkon, duke vlerësuar burimet alternative, për ndërtimin e ngjarjes historike; - identifikon, zgjedh dhe përdor një sërë burimesh historike, duke përfshirë burimet tekstuale, vizuale, objektet dhe mjedisin historik; TIK; - vlerëson cilësinë e burimet te përdorura për të arritur përfundime të arsyetuara dhe logjike e të besueshme;
<i>Kompetenca: Interpretimi historik</i> Kjo kompetencë ka të bëjë me të kuptuarit se si historianët dhe të tjerët formojnë interpretime për të kaluarën në mënyra të ndryshme, duke përfshirë fotografi, shfaqje, filma, tregime, muzeume etj.	<i>Disa tregues kryesorë janë:</i> - kupton pse historianët dhe të tjerët i kanë interpretuar ngjarjet, njerëzit dhe situatat në mënyra të ndryshme bazuar një sërë burimesh dhe mediash; - shpjegon se si dhe pse ngjarjet historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme; - shqyrton një sërë interpretimesh të së kaluarës për të vlerësuar vlefshmërinë e

	tyre nga këndvështrimi i burimeve dhe alternative të reja historike.
Kompetenca: Analiza shkak - pasojë Kjo kompetencë ka të bëjë me identifikimin dhe vlerësimin e rëndësisë relative të faktorëve të ndryshëm, si dhe shpjegimin e lidhjeve ndërmjet shkakut dhe pasojës, duke pasur parasysh marrëdhënien ndërmjet argumenteve, dëshmive dhe interpretimeve.	Disa tregues kryesorë janë: - analizon ngjarjet historike në lidhjet e tyre shkak-pasojë; - shpjegon pasojat në përfundimin e ngjarjeve, të situatave dhe të ndryshimeve historike. - shikon të sotmen si rezultat i ngjarjeve historike të kaluar ose si reflektim ndaj tyre.
Kompetenca: Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën Kjo kompetencë ka të bëjë me zhvillimin e aftësive të të dëgjuarit, të të lexuarit të të shkruarit, të përdorimit të TIK-ut, si aftësi bazë për të kujtuar, për të përzgjedhur, për të klasifikuar dhe për të organizuar informacionin historik, duke përdorur me saktësi terminologjinë historike për përshkrimin dhe për shpjegimin e ngjarjeve në të shkuarën	Disa tregues kryesorë janë: - paraqet shpjegime rreth së kaluarës që janë koherente, të strukturuar dhe të arsyetuara, duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik; - komunikon njohuritë historike në mënyra të ndryshme, duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik; - përdor TIK-un për të kërkuar informacion për të shkuarën në lidhje me datat, personazhet, objektet, ngjarjet dhe proceset historike, si dhe për të përzgjedhur, klasifikuar, organizuar dhe paraqitur gjetjet.

Në programet e historisë, për secilën klasë, janë menduar veprimtari, të cilat jepen në rubrikën “Situata të nxëni të sugjeruara”. Nëpërmjet këtyre veprimtarive nxënësi zbaton në situata praktike kompetencat e lëndës dhe kompetencat kyçe. Po ashtu në programet e historisë janë dhënë Rekomandimet Rek (2001)¹⁵ e Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropë në shekullin XXI, të cilat çdo mësues duhet t’i ketë parasysh gjatë zhvillimit të lëndës së historisë.

2.3. Shtrirja e lëndës së historisë në Arsimin e Mesëm të Lartë

Programet e reja të lëndës së historisë për AML-në, parashikojnë një cikël studimesh, si lëndë bërthamë për dy vite (klasa 10 – 11) dhe si lëndë me zgjedhje për vitin e fundit (klasa 12).

- Në klasat 10-të, 11-të, lënda e historisë zhvillohet me dy orë në javë.
- Në klasën e 12-të lënda e historisë zhvillohet me katër orë në javë.

Tabela: Plani mësimor për lëndën e historisë në AML

Klasa	10	11	12	Totali i orëve të historisë në AML
Plani mësimor Histori	2	2	4	280

Lënda e historisë **në arsimin e mesëm të lartë**, shkalla e pestë dhe e gjashtë e kurrikulës, **klasa e 10-të, e 12-të, trajton historinë botërore dhe historinë e shqiptarëve**, në periudhën e parahistorisë, në periudhën antike, në periudhën moderne dhe në periudhën bashkëkohore.

Tabela: Koha mësimore për secilën tematikë në Arsimin e Mesëm të Lartë

KLASA e 10-të	
Tematika	Orë të sugjeruara
Proceset historike, koha, ndryshimi dhe vazhdimësia	72
1. Qytetërimi antik Grek dhe Romak	8
2. Qytetërimet botërore në Mesjetë (Shek. V – Shek. XV)	11
3. Qytetërimet në fillimet e historisë moderne	7
4. Koha e ndryshimeve thelbësore.	16
5. Periudha tronditjeve të mëdha (1914-1945)	13
6. Qytetërimet bashkëkohore (1945 – sot)	17
KLASA e 11-të	
1. Parahistoria dhe antikiteti në territoret shqiptare.	10

2. Territoret shqiptare në Mesjetë.	8
3. Shqiptarët në fundin e shekullit XIV deri në fillimin e shekullit XX.	16
4. Shqipëria dhe shqiptarët 1912 – 1939.	12
5. Shqiptarët dhe Lufta e Dytë Botërore .	7
6. Shqipëria gjatë regjimit komunist 1945 – 1990.	12
7. Rënia e regjimit komunist. Fitorja e demokracisë.	7
KLASA e 12^{-të}	
Tematika	Orë të sugjeruara
Proceset historike, koha, ndryshimi dhe vazhdimësia	136
1. Historia dhe historiani	5
2. Antikiteti	16
3. Mesjeta (shek. IV – XIV)	25
4. Periudha moderne (shek. XV – fillimi i shekullit XX)	37
5. Periudha bashkëkohore (1919 deri më sot)	50
Testime	3

III. MODELE TË ZHVILLIMIT TË KOMPETENCAVE KYÇE NËPËRMJET KOMPETENCAVE TË LËNDËS

Programi i historisë, nëpërmjet temave, veprimtarive praktike, projekteve, krijon kushteve për ndërtimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to, për të gjithë nxënësit në arsimin e mesëm të lartë. Për të realizuar në praktikë lidhjen mes kompetencave të lëndës me kompetencat kyçe, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat e të nxënësve, veprimtaritë dhe metoda/teknika që bëjnë të mundur realizimin e tyre. Kompetenca përcaktohet si demonstrim i njohurive, qëndrimeve dhe vlerave që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies.

Kompetenca është ndërthurja e dijeve, e aftësive, e qëndrimeve, e vlerave që u nevojiten nxënësve për zhvillimin vetjak, qytetarinë aktive, përfshirjen shoqërore dhe punësimin në të ardhmen. Përcaktimi i kompetencave kyçe, të shprehura me rezultate konkrete të të nxënësve, si dhe përcaktimi i kriterëve për vlerësimin e zhvillimit dhe të arritjeve, sigurojnë kushtet për mundësi të barabarta për formim cilësor të nxënësve. Kurrikula e historisë mundëson fleksibilitet për mësuesin në planifikimin e përvojave të të mësuarit të cilat janë të rëndësishme për zhvillimin e nxënësve. Më poshtë prezantohen disa shembuj/modele që bazohen në tema konkrete ku evidentohen rrugë dhe metoda për të përmbushjen e rezultateve të të nxënësve për realizimin e kompetencave kyçe nëpërmjet lëndës së historisë. Shembujt e mëposhtëm të zhvillimit të kompetencave kyçe nëpërmjet zhvillimit të kompetencave historike dhe përmbajtjes së lëndës nuk janë shteruese. Ato pasurohen nga vetë mësuesit.

Shembull 1.

Klasa	Tema	Metodologjia	Mjete ndihmëse
11	Konfliktet iliro – romake	Lexim i drejtuar/ INSERT	PC, projektor, material video për demonstrim.
Kompetencat kyçe - <i>Kompetenca e të nxënësve;</i> - <i>Kompetenca e të menduarit;</i>			
Kompetencat e lëndës - <i>Analiza shkak – pasojë;</i> - <i>Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën;</i>			

- Nxënësve u kërkohet nga mësuesi të japin koncepte kryesore lidhur me ato që kanë mësuar në temat e mëparshme lidhur me jetën, ekonominë dhe organizimin e shtetit ilir. Në këtë mënyrë synohet të realizohet **kompetenca e të menduarit**, nëpërmjet përpjekjes për diferencim mes asaj që është kryesore dhe asaj që është dytësore nga pikëpamja historike. Mendimet e shprehura nga nxënësit, integrohen edhe me pamje filmike të përzgjedhura prej mësuesit dhe që u referohen informacioneve të diskutuara.
- Nxënësit udhëzohen që të kryejnë leximin e materialit të librit. Leximi kryhet në mënyrë individuale me qëllimin për t'i dhënë nxënësit një informacion paraprak mbi periudhën historike që do të trajtohet gjatë orës së mësimit. Paralelisht, mësuesi kërkon nga nxënësit që

ata të evidentojnë informacionet më domethënëse sipas mendimit të tyre. Synohet që të kemi një realizim të ndërthurur mes **kompetencës së të nxënës** (informacion dhe koncepte të reja) dhe **kompetencës së të mësuarit** (diferencim mes koncepteve bazë dhe informacionit ndihmës apo ilustrues).

- *Dinastia e Agronit, pati shumë sukses në fuqizimin ekonomik, politik dhe ushtarak të mbretërisë.*
- *Fitorja e bujshme e Agronit ndaj ushtrisë etole në qytetin Medion në 231 p.e.s.*
- *Vdekja e papritur e mbretit Agron, i cili i u pasua në fronin ilir nga Teuta, bashkëshortja e tij.*
- *Shkaku i konflikteve iliro-romake ishin synimet territoriale që kishte Roma në Ballkan.*
- Bazuar në punën përgatitore, mësuesi udhëzon nxënësit që të procedojnë në bazë të metodës INSERT. Konkretisht, nxënësve u kërkohet që të vendosin përbri secilës pjesë të lexuar shenjat të cilat kanë kuptimin e mëposhtëm:
 - ✓ “ – ” vendoset përbri informacionit që është i njohur për nxënësin;
 - “ - ” vendoset përbri informacionit që rezulton i ndryshëm nga ai që nxënësi di;
 - “ + ” vendoset përbri informacionit i cili është i ri për nxënësin;
 - “ ? ” vendoset përbri informacionit i cili është i pa qartë ose për të cilin nxënësi do të donte të dinte më shumë.
- Mësuesi synon të realizojë kompetencën e lëndës **“shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën”**, nëpërmjet leximit dhe shkrimit si aftësi për të përzgjedhur dhe organizuar informacionin historik. Diskutohen informacionet kryesore që kanë nxjerrë nxënësit duke evidentuar të përbashkëtat në këto informacione.
- Mësuesi përqendrohet kryesisht në informacionin e panjohur tërësisht apo pjesërisht për nxënësin apo në atë informacion që rezulton i ndryshëm nga dijet e nxënësit. Në këtë pikë, mes të tjerave, zhvillohet kompetenca e lëndës **“analiza shkak – pasojë”** nëpërmjet:
 - a) diferencimit mes shkakut të rremë (pretekstit) dhe shkaqeve reale të luftërave iliro – romake;
 - b) efektit dhe ndikimit të luftërave iliro – romake mbi organizimin politik, territorin dhe jetën e popullsisë ilire.

Përfundimi: Kompetencat quhen të realizuara nëse nxënësi:

- shpjegon shkakun e luftërave iliro – romake;

- përshkruan zhvillimin e tre luftërave iliro-romake;
- tregon përpjekjet e vazhdueshme të ilirëve për t'i bërë ballë Romës;
- shpjegon ndryshimet që solli vendosja e plotë e sundimit romak në Iliri;
- identifikon disa prej risive në fushën e artit dhe arkitekturës si pasojë e ndikimit romak.

Shembull 2.

Klasa	Tema	Metodologjia	Mjete ndihmëse
10	Revolucioni francez i shekullit XVIII	Punë kërkimore/diskutim/të menduarit kritik përmes leximit.	PC, projektor, material video për demonstrim.
Kompetencat kyçe - <i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</i> - <i>Kompetenca personale</i>			
Kompetencat e lëndës - <i>Kërkimi historik</i> - <i>Interpretimi historik</i>			

- Me qëllim nxitjen e interesit të nxënësve, mësuesi u cakton nxënësve që më parë, duke i ndarë paraprakisht në grupe, të krijojnë një ekspozitë me pamje nga revolucioni francez:
 - foto të figurave kryesore historike (Robespierit, Dantonit, MariaAntuanetës, Luigjit XVI etj.);
 - foto të ngjarjeve a dokumenteve më domethënëse të këtij procesi historik (sulmi mbi Bastijë dhe pallatin Tyileri, Deklarata e të Drejtave të Njeriut.). Në kryerjen e kësaj pune përgatitore, mësuesi synon të realizojë kompetencën për **sipërmarrjen, jetën dhe mjedisin** (kompetencë e përgjithshme) dhe kompetencën për **kërkim historik** (kompetencë e lëndës).

Pas prezantimit të fotove mësuesi drejton pyetjet e mëposhtme:

- Cila dinasti sundonte në Francë?
- Cila ishte forma e qeverisjes në Francë në prag të shpërthimit të revolucionit?
- Si e kuptoni ju termin “absolutizëm”? Si shprehej “absolutizmi” në Francë?
- Ç’ishin përfaqësitë e përgjithshme?

- Duke u nisur nga fotot, përshkruani në mënyrë sintetike revolucionin francez (nxënësit nxiten të shfaqin mendimet e tyre të lira).
- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën e parë të mësimit dhe evidentojnë:
 - jetën ekonomiko - shoqërore në Francë në prag të revolucionit;
 - shkaqet e revolucionit.
- Pasi merr mendimin e disa nxënësve, mësuesi paraqet në dërrasën e zezë disa koncepte bazë. Për ilustrim dhe në funksion të synimit për realizimin e kompetencave, theksi mund të vendoset tek:
 - përhapja e ideve iluministe. mësuesi këmbëngul në vlerën dhe rolin e këtyre ideve për emancipimin shoqëror dhe politik. gjithashtu, në varësi të kohës në dispozicion, mësuesi mund të kërkojë mendimin e nxënësve për idetë dhe rolin e figurave të ndryshme të lëvizjes iluministe;
 - pabarazia ekonomike dhe politike ndërmjet shtresave të shoqërisë franceze. mësuesi pyet se cilat ishin shtresat shoqërore, çfarë të drejtash ekonomike dhe politike kishin ato.
 Idetë e mësipërme lidhen me realizmin e **kompetencës personale** nëpërmjet kërimit historik të përvojës së njeriut, rëndësisë historike, ndryshimeve dhe vazhdimësisë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave.
- Në vazhdim të zhvillimit të mësimit bazuar në kompetenca, mësuesi mund të përdorë çështjet e mëposhtme në funksion të realizimit të kompetencës së lëndës “**interpretimit historik**”:
 - Cilat ishin reformat e Asamblesë Kombëtare? Në veçanti mund t’i referohet miratimit të Deklaratës së të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit dhe elementeve të saj (barazi para ligjit, sovraniteti kolektiv i popullit.)
 - Miratimi i kushtetutës civile dhe ndarjes së shtetit nga kisha.

Sa më sipër, mësuesi nxit zhvillimin e **kompetencës së të menduarit** nëpërmjet pyetjes: Cili ishte ndikimi i Revolucionit në qytetërimin botëror?

- Në mbyllje, mësuesi mund të përdorë idetë e mëposhtme për të forcuar shprehitë e **interpretimit historik** tek nxënësit:
 - Cilat ishin grupimet kryesore politike gjatë periudhës së Revolucionit Francez dhe cila ishte përbërja e tyre? Ku dhe si diferencoheshin ata nga njëri – tjetri?
 - Jakobinë (grupi radikal i Revolucionit);
 - Zhirondinë (përfaqësues të borgjezisë tregtare industriale, të moderuarit);
 - Sankylotë ((populli i thjeshtë)

- Cili ishte cikli i revolucionit? Cilat grupe dolën fitues prej tij dhe përse? (*interpretim historik*).
- Cili ishte fati i disa prej protagonistëve kryesorë të tij? Gjykoni rreth rolit të individit në ngjarje të mëdha historike. Si do të vepronit ju në të njëjtat rrethana historike? (*kompetenca personale*). Analizojnë idetë e reja të Revolucionit Francez dhe ndikimin e tyre në qytetërimin botëror.

Përfundimi: Kompetencat quhen të realizuara nëse nxënësi:

- identifikon dhe analizon shkaqet e Revolucionit Francez;
- shpjegon fazat e Revolucionit Francez;
- analizon idetë e reja të Revolucionit Francez dhe interpreton ndikimin e tyre në qytetërimin botëror.

Shembull 3.

Klasa	Veprimtaria praktike	Metodologjia	Mjete ndihmëse
11	Jeta e përditshme në periudhën komuniste	Rrjeti i diskutimit. Vështrim krahasues.	PC, projektor, material video për demonstrim, internet.
Kompetencat kyçe - <i>Kompetenca për komunikimin dhe shprehjen</i> - <i>Kompetenca qytetare</i> - <i>Kompetenca digjitale</i>			
Kompetencat e lëndës - <i>Përdorimi i burimeve historike</i> - <i>Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën</i>			

- Veprimtaria praktike ofron një terren të përshtatshëm për të zhvilluar dhe ndërtuar disa kompetenca. Në rastin konkret nxënësit udhëzohen që të mbledhin informacion dhe të intervistojnë të afërm apo familjarë për përvojat e tyre jetësore gjatë periudhës komuniste. Kryerja e intervistave mund të konsiderohet si një punë e mirëfilltë me një burim apo dëshmitar të një periudhe historike (*përdorimi i burimeve*). Kryerja e intervistave mund të

lihet në dorë të nxënësve për sa i përket natyrës dhe pyetjeve të bëra, ose mund të strukturohet mbi bazë grupe nxënësish.

Ide për intervistën

- *Si ndërtoheshin marrëdhëniet prindër-fëmijë apo marrëdhëniet mes brezave?*
 - *Cilat ishin modelet e sjelljes në familje?*
 - *Çfarë mundësish ofroheshin për të rinjtë në kohën e lirë?*
 - *A ndërhynte shtetin në kohën e lirë të individëve?*
 - *Cilat ishin vështirësitë e përditshme me të cilat përballeshin familjet?*
 - *Si reagonte shoqëria në lidhje me veprimet e individit?*
 - *Mblidhni informacione lidhur me normat shoqërore gjatë jetës në sistemin komunist.*
 - *Cili mendoni se kishte përparësi, individ apo shoqëria?*
 - *Cilat mendoni se janë disa prej ndryshimeve kryesore në jetën e përditshme në kalimin nga diktatura në demokraci?*
-
- Gjithashtu, një element shumë i rëndësishëm i materialeve që mund të shqyrtohen gjatë kësaj faze përgatitore, janë ato me karakter audiovizual, si dhe objekte apo foto me karakter personal që nxënësit mund të sigurojnë nga familjarë apo të afërm.
 - Përveç punës me burime historike, me anë të veprimtarive të përshkruara më sipër realizohet **kompetenca digjitale**, si nëpërmjet përdorimit të internetit, ashtu edhe nëpërmjet përdorimit eventual të teknikave digjitale disi më komplekse për përgatitjen dhe paraqitjen e një pjese të materialeve të grumbulluara (kryesisht ato me natyrë audio – video).
 - Paraqitja e informacioneve, materialeve apo të dhënave të mbledhura nga nxënësit.

Kjo fazë, në varësi të kohës në dispozicion, mund të kryhet mbi baza individuale ose në bazë grupesh. Paraqitja mund të bëhet në formë tregimi ose në formë prezantimi vizual (Powerpoint apo tjetër). Në rast se janë mbledhur një numër fotosh, mund të procedohet edhe me përgatitje albumesh apo forma të ngjashme paraqitje. Mësuesi synon që nxënësit të arrijnë të japin disa përfundime lidhur me aspekte të ndryshme të jetës së përditshme në diktaturë duke u përpjekur që nga rastet individuale, të kalohet në përgjithësi (**kompetenca e komunikimit; kompetenca digjitale**).

- Diskutim në klasë

Mësuesi nxit nxënësit që të vënë në përdorim aftësinë e tyre krahasuese duke marrë në analizë aspekte të caktuara të jetës (të diskutuara më sipër ose të tjera) mes periudhës së diktaturës dhe

ditëve të sotme. Krahاسimi synon që të nxisë aftësinë për mendim kritik tek nxënësit duke nxjerrë në pah ndryshimet e ndodhura në Shqipëri, gjatë kalimit nga diktatura në demokraci si në sensin pozitiv, ashtu edhe atë negativ (***kompetenca e të menduarit***). Synimi është që nxënësit të kuptojnë përparësitë e sistemit demokratik, por edhe të ndërgjegjësohen për difektet e këtij të fundit dhe nevojën e vazhdueshme për përmirësim në normat dhe sjelljet shoqërore me qëllim përparimin social dhe ekonomik të vendit. Theksi mund të vihet në rolin e rinisë dhe edukimit të saj me vlerat demokratike në mënyrë që të rinjtë të bëhen qytetarë të denjë dhe të japin kontributin e tyre në mbarëvajtjen e demokracisë shqiptare, ndërtimin e vlerave evropiane dhe çuarjen përpara të procesit të integrimit evropian të Shqipërisë si një zhvillim me rëndësi jetike për të ardhmen e vendit (***kompetenca qytetare***).

Në përfundim, mësuesi bën konkluzionet e diskutimit dhe vlerëson nxënësit lidhur me argumentet e paraqitura dhe pjesëmarrjen në diskutim.

IV. INTEGRIMI NDËRLËNDOR

Integrimi ndërlëndor brenda dhe jashtë fushës së të nxënit mundëson lidhjen e historisë me lëndët brenda fushës dhe me fushat e tjera kurrikulare, në mënyrë që kurrikulae arsimit të mesëm të lartë të shihet si një e tërë për formimin e nxënësit dhe për realizimin e qëllimeve kryesore të shkollës dhe të shoqërisë në fushën e arsimit.

Në lëndën e historisë, temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballen shoqëria tani dhe në të ardhmen. Zhvillimi i tyre ndihmon nxënësit të interpretojnë botën dhe të bëjnë lidhjen e arsimit me jetën dhe me interesat e saj. Trajtimi i këtyre temave në lëndën e historisë synon ndërtimin e disa njohurive specifike, zbatimin e disa aftësive, vlerave e qëndrimeve të caktuara te nxënësit për zhvillimin e tyre si qytetarë të së ardhmes, të cilët do të jenë të aftë për të bashkëvepruar në paqe me kultura të ndryshme, të aftë për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe të aftë për të funksionuar në një botë të ndërvarur, duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm të saj.

Model 1

Integrimi ndër lëndor brenda fushës së të nxënit

Kjo tipologji integrimi ndërkurrikular bazohet në përfshirje, nga ana e mësuesit të historisë, të tematikave apo materialeve nga lëndë të tjera gjatë mësimdhënies. Aspekti pozitiv i kësaj metode

është se mësuesi e administron tërësisht vetë zhvillimin e mësimit dhe nuk ka problem koordinimi me mësues të tjerë. Gjithashtu, materiali i integruar i referohet në mënyrë specifike informacionit që përfshihet në shpjegim.

Përshkrim i shkurtër: Në temën “Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe vendimet e saj për Shqipërinë”, mësuesi liston tiparet e pozitës gjeografike dhe rëndësinë e ndikimit të saj në zhvillimin e ngjarjeve historike të popullit shqiptar. Në zhvillimin e kësaj teme mësuesi mund të integrojë elementë që lidhen me aspektin e shtrirjes gjeografike të popullsisë shqiptare në Ballkan dhe ndikimin e kësaj pozite në trajtimin e pozitës politike të këtyre trevave nga diplomacia evropiane në fillim shekullin e XX.

Skema e integritimit

Klasa	Histori	Gjeografi
11	<i>Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe vendimet e saj për Shqipërinë</i>	<i>Pozita gjeografike dhe përbërja e trevave shqiptare.</i>
	- Kushtet historike në të cilat u mbajt Konferenca e Ambasadorëve në Londër në vitin 1913. - o Luftërat ballkanike dhe ndikimi i tyre në trevat shqiptare; - o Çështjet kryesore të trajtuara në këtë konferencë; - o Pretendimet territoriale të shteteve fqinje ndaj trevave shqiptare; - Vendimet e Konferencës së Londrës në caktimin e kufijve të shtetit shqiptar.	- Ndikimi i pozitës gjeografike të trevave shqiptare në fatin e tyre historik. - Cilat janë trevat kryesore shqiptare në Ballkan; - Rëndësia gjeopolitike e trevave shqiptare si urë lidhëse mes Lindjes dhe Perëndimit; - Rëndësia strategjike dhe ndikimi i saj në orekset territoriale të fqinjëve; - Rëndësia ekonomike që lidhet me pasuritë natyrore, lidhjen me bregdetin, mundësitë infrastrukturore.

Ide alternative

Në temën që zhvillohet në Historia 11 “Rilindja Kombëtare dhe tiparet e programit politik të rilindësve shqiptarë”, mund të trajtohet ndikimi i ideve iluministe tek ideologjia dhe mendimi politik që karakterizoi dhe mbështeti Rilindjen Kombëtare Shqiptare.

Model 2

Integrimi shumëdisiplinar

Ky integrim kërkon planifikim dhe koordinim shumë të mirë mes mësuesve. Në këtë skenar dy ose më shumë lëndë ndajnë një temë të përbashkët që ua paraqesin nxënësve në mënyrë të integruar. Klasat bashkohen në të njëjtin ambient. Mësuesit krijojnë një ditari të përbashkët dhe zhvillojnë si një ekip mësimdhënien. Aftësia për të punuar në skuadër është aspekti më i rëndësishëm për një mbarëvajtje sa më të mirë të projektit. Në vend të kryerjes së mësimit në mënyrë të ndarë, procedohet me një kombinim të lëndëve për të siguruar që kërkesat e programeve të lëndëve të integruara të plotësohen në mënyrë sa më efektive të jetë e mundur.

Në vijim jepet modeli i një plani mësimor të përbashkët për zhvillimin e orës së mësimit mes lëndëve histori dhe ekonomi 12. Për vetë specifikat e tematikave të trajtuara, rekomandohet edhe një integrim me elementë të zhvilluara në Historinë 10 (Histori Botërore) për subjektin e përzgjedhur.

Puna përgatitore në planifikim konsiston në:

- përgatitjen e një plani ditor (ditari) të përbashkët për zhvillimin e orës mësimore;
- identifikimin e materialeve të përbashkëta ndihmëse që mund të përdoren gjatë mësimit;
- ndarjen e detyrave mes mësuesve përgjatë orës mësimore;

Temat mësimore

“Kriza ekonomike botërore dhe rrjedhojat në Ballkan” (Historia 12) e integruar me “SHBA-modeli i një shteti liberal” (Histori 10), “Ndërhyrja e shtetit në ekonomi” (Ekonomia – Klasa 12)

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:

- Shqyrton, ndërton analizon dhe parashtron pyetje për të argumentuar informacionin, konceptet historike. ***(Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit)***
- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. ***(Kompetenca e të nxënit)***

- Shqyrton burimet historike për të kuptuar çështjet shoqërore dhe se si parime të ndryshme kanë ndikuar në çështjet njerëzore. **(Kompetenca qytetare)**
- Zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë qartë aspekte të së shkuarës që janë të diskutueshme. **(Kompetenca e të menduarit)**

Skema e integritit

Klasa	Histori	Ekonomi
12	- analizon shkaqet dhe tiparet e krizës ekonomike botërore; - përshkruan tiparet e shfaqjes së krizës në vendet e Ballkanit - krahason rrugëdaljet nga kriza në SHBA dhe në vendet e Ballkanit; - gjykon mbi rrjedhojat politike të krizës në Ballkan.	- shpjegon këndvështrimet e teorisë ekonomike mbi rolin e qeverisë; - analizon funksionet e qeverisë në një ekonomi tregu; - gjykon mbi rolin e shtetit nën dritën e zhvillimeve të sotme në ekonominë botërore.

Në përfundim zhvillohet një diskutim dhe shkëmbim mendimesh në lidhje me krizën globale të fundit dhe ndonjë zhvillim i teorisë ekonomike për shkak të saj.

Integrimi shumëdisiplinar mund të materializohet edhe në formën e një moduli ndërlëndor, si një nivel më ambicioz dhe që synon një ndërthurje lëndore më organike. Për ilustrim, më poshtë paraqitet skeleti i një moduli të tillë.

Model 3

Tema: Realizmi Socialist në Shqipëri, si mënyrë e organizimit të jetës dhe si shprehje krijuese e saj në letërsi.

Skema e integritit

Klasa 12			
Histori 1944 – 1990	Qytetari	Letërsi 1944 – 1990	TIK
- përcakton epokën e vendosjes së	- familjarizohet me strukturat	- njeh procesin letrar gjatë	- paraqet materialet e mbledhura në formë

komunizmit në Shqipëri. - evidenton rolin e kampit socialist në vendin tonë. - shpjegon vijën ideologjike dhe imponimin e saj në fusha të ndryshme. - vlerëson mënyrën e indoktrinimit dhe krijimit të njeriut të ri. - reflekton mbi disidencën si dukuri politike e mendimit ndryshe gjatë epokës.	shoqërore dhe organizimin e familjes si institucion gjatë periudhës së regjimit totalitar; - analizon rolin e gruas në shoqëri si nënë, bashkëshorte, krah pune dhe mjet propagandistik që ushqente ideologjinë e asaj kohe; - informohen, dhe mësojnë se si të analizohet mungesa e lirive civile të individit gjatë asaj periudhe, që ushqehet dhe imponohet nga ideologjia dominuese e regjimit; - ushqen debatin kritik në diskutimin dhe analizën e shoqërisë klasore,	viteve të regjimit komunist në Shqipëri. - evidenton autorët dhe veprat më të spikatura të epokës. - shpjegon arritjet dhe vlerat artistike duke u ndalur në krijuesit e viteve '60 në poezi e prozë. - vlerëson risitë dhe frymën moderne të kësaj letërsie në raport me letërsinë shqipe paraardhëse. - vlerëson rolin emancipues të Kadaresë në poezinë dhe prozën shqipe. - reflekton mbi vlerat humaniste të disidencës si prirje letrare e	audio – vizive ose programe të ndryshme kompjuterike. - shfrytëzon njohuritë nga interneti në adresat të ndryshme me materiale mbi temën e dhënë. - realizon paraqitjen përfundimtare të projektit me materialet e përzgjedhura nga të gjitha lëndët.
--	--	---	---

	si një fenomen që dënohej nga ideologjia dominante, por shfaqej gjatë regjimit nëpërmjet nocionit të “luftës së klasave”. - shpjegon se përse ishte e domosdoshme për regjimin totalitar të censuronte nëpërmjet mediave për një kontroll total të shoqërisë civile.	politike e epokës. - reflekton mbi vlerat e mesazhet që mbart kjo krijimtari në kuadrin e përgjithshëm të historiografisë së letërsisë shqipe.	
--	--	---	--

V . TEMAT NDËRKURRIKULARE

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Zhvillimi i tyre ndihmon nxënësit të interpretojnë botën dhe të bëjnë lidhjen e arsimit me jetën dhe me interesat e saj.

Temat ndërkurrikulare: *Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; Të drejtat e njeriut; Vendimmarrja morale; Zhvillimi i qëndrueshëm; Mjedisi; Ndërvlerësia; Bashkëjetesa paqësore;* ofrojnë dimensione, të cilat pasurojnë lëndën e historisë dhe përshtaten natyrshëm brenda tematikave të historisë.

Integrimi i këtyre temave gjatë zhvillimit të koncepteve dhe kompetencave historike aftëson nxënësit:

- për t’u bërë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm në dimensionet lokale, kombëtare, rajonale, evropiane e globale, duke u mundësuar atyre të ndërtojnë identitetin individual dhe kolektiv përmes njohjes së trashëgimisë së tyre historike të përbashkët;

- për të ndërvepruar me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme, për të njohur të kaluarën dhe për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike;
- për t'u edukuar me ndenjen e mirëkuptimit dhe të besimit të ndërsjellë midis popujve, nëpërmjet studimit të kulturës, të shkëmbimeve të shumanshme dhe të trashëgimisë;
- për të ndihmuar në formimin e një të ardhmeje më të mirë përmes kuptimit të asaj se si e shkuara ka lidhje me të tashmen dhe për të marrë vendime për një zhvillim të qëndrueshëm të perspektivave historike;
- për të zhvilluar aftësitë qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri.

Gjatë realizimit të temave ndërkurrikulare nxënësi duhet të zgjidhë situata, duhet të përdorë aftësitë e mendimit kritik, krijues, të përdorë kompetencat historike si: kërkimin, përdorimin e burimeve, interpretimin dhe komunikimin për të shpjeguar, argumentuar dhe parashikuar perspektivat për çështje të ndryshme që lidhen me këto tema ndërkurrikulare.



Shembull 1: Bashkimi Evropian

Lënda: Histori

Klasa: 11

Tema: Bashkimi Evropian

Rezultatet e të nxënit:

- evidenton Traktatin e Mahstrittit, si vazhdues të procesit të integritimit evropian dhe krijuesin e Bashkimit Evropian;
- vlerëson rolin dhe rëndësinë e Bashkimit Evropian;
- liston në mënyrë skematike institucionet kryesore vendimmarrëse të Bashkimit Evropian, duke evidentuar misionin e tyre;
- analizon procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian;
- gjykon mbi bashkëjetesën paqësore në Evropë;
- kërkon dhe shfrytëzon burime të besueshme për temën mësimore dhe temat ndërkurrikulare: *bashkëjetesa paqësore, identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; ndërvarësia, të drejtat e njeriut; vendimmarrja morale;*

- ilustron me shembuj nga jeta e përditshme dhe zhvillimet në botë konceptin e bashkëjetesës paqësore midis popujve;
- vlerëson bashkëjetesën paqësore fetare në Shqipëri;
- gjykon mbi kontributin e tij si qytetar në zhvillimin e shoqërisë.

Gjatë kësaj ore mësimore mësuesi zhvillon dhe ndërton një sërë njohurish, aftësish, qëndrimesh dhe vlerash të caktuara të nxënësit për zhvillimin e tyre si qytetarë të së ardhmes, të cilët do të jenë të aftë për të bashkëvepruar në paqe me kultura të ndryshme, të aftë për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe të aftë për të funksionuar në një botë të ndërruar, duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm të saj. Në këtë temë mësimore janë të përfshira dhe preken *temat ndërkurrikulare: Bashkëjetesa paqësore, Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; Ndërrarësia, Të drejtat e njeriut; Vendimmarrja morale.*

Veprimtaritë mësimore:

1. Stuhi mendimi

Mësuesi shkruan në dërrasë dhe diskuton me nxënësit rreth koncepteve bazë të temës “Bashkimi Evropian”, si dhe konceptet bashkëjetesë paqësore në shoqëri dhe midis popujve, *njohja e kulturave, identiteti kombëtar*, grupet shoqërore, dallimet midis grupeve shoqërore, ndasitë dhe bashkëpunimi midis tyre, ndërrarësia, të drejtat e njeriut, toleranca dhe konflikti, konflikti dhe dhuna, vendimmarrja morale.

2. Diskutim

Mësuesi lexon pjesën e mëposhtme të shkëputur nga fjala e Papa Françeskut

Bashkëjetesa fetare është e mundur. Shqipëria është shembulli i kësaj gjëje

Respektimi i të drejtave njerëzore – respekti është fjalë themelore për ju – ndër të cilat spikat liria fetare dhe ajo e shprehjes së mendimit, është kushti paraprak për vetë zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të një vendi. Kur respektohet dinjiteti i njeriut dhe njihen e garantohen të drejtat e tij, lulëzon edhe shpirti krijues e nismëtar, e personaliteti njerëzor mund t'i shpalosë nismat e veta në dobi të së mirës së përbashkët.

Ju përgëzoj posaçërisht për një karakteristikë fatlume të Shqipërisë, që duhet ruajtur me shumë kujdes e vëmendje: e kam fjalën për bashkëjetesën paqësore dhe bashkëpunimin ndërmjet anëtarëve të feve të ndryshme. Klima e respektit dhe e besimit të ndërsjellë ndërmjet katolikëve, ortodoksëve e myslimanëve është pasuri e çmueshme për vendin dhe fiton rëndësi të veçantë në kohën tonë, në të cilën grupet ekstremiste e shtrembërojnë kuptimin e vërtetë fetar dhe i

përçudnojnë e instrumentalizojnë dallimet ndërmjet besimeve të ndryshme, duke i kthyer në faktorë të rrezikshëm përplasjeje e dhune, e jo në mundësi për dialog të hapur e për përsiatje të përbashkët rreth domethënies që ka besimi në Hyjin e zbatimi i ligjit të tij.

Askush të mos e përdorë fenë si pretekst për veprimet që bien në kundërshtim me dinjitetin e njeriut e me të drejtat e tij themelore, në radhë të parë me të drejtën e jetës dhe të lirisë fetare të të gjithëve!

Bashkëjetesa paqësore ndërmjet bashkësive të ndryshme fetare, në të vërtetë, është pasuri e paçmueshme për paqen dhe zhvillimin e harmonishëm të një populli. Është vlerë, që duhet ruajtur e duhet ushqyer çdo ditë me edukimin për të respektuar dallimet dhe identitetet specifike, të gatshme për dialog e bashkëpunim në dobi të të gjithëve, duke e njohur dhe duke e nderuar njëri-tjetrin. Uroj që Shqipëria ta vijojë këtë udhë, duke u bërë për shumë vende shembull frymëzimi.

Mësuesi nxit dhe monitoron diskutimet në klasë për pyetjet e mëposhtme:

- *Si e vlerësoni fjalën e Papa Franceskut?*
- *Cilat nga konceptet e përdorura në këtë fjalim mendeni se ndihmojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e temës mësimore?*
- *Në cilat lëndë i keni zhvilluar dhe përdorur këto koncepte?*
- *Pse u krijua Bashkimi Evropian?*
- *Cilat janë detyrat dhe funksionet që ai ka?*
- *Propozoni koncepte të tjera dhe argumentoni përse mendeni se janë të nevojshëm për trajtimin e temës mësimore.*
- *Tregoni disa burime që mund të shfrytëzohen për konceptimin dhe zhvillimin e temës mësimore.*

3. Punë në grupe në laboratorin e TIK-ut

Nëse nuk ka shkollë laborator, një orë më parë mësuesi u jep nxënësve të kërkojnë për temat më poshtë dhe në klasë ata klasifikojnë, organizojnë dhe interpretojnë informacionet që kanë gjetur në lidhje me detyrën e dhënë .

Mësuesi ndan nxënësit në grupe dhe jep këto detyra specifike për secilin grup:

- Grupi i parë: gjejnë mbi rolin që pati Traktati i Mahstritit, në procesin e integritetit evropian dhe krijimin e Bashkimit Evropian. Jep shembuj të shoqërive evropiane që jetojnë së bashku në paqe, larg dhunës, pavarësisht nga dallimet në përkatësitë etnike, fetare, kulturore, gjinore, ekonomike, sociale.

- Grupi dytë: jep shembuj të shoqërive evropiane ku dallimet midis grupeve brenda vendit apo midis vendeve të ndryshme kanë çuar në konflikte dhe përshkallëzim të dhunës. Vlerëson rolin dhe rëndësinë e Bashkimit Evropian në zgjidhjen e konflikteve.
 - Grupi i tretë: liston në mënyrë skematike institucionet kryesore vendimmarrëse të Bashkimit Evropian (BE), duke evidentuar misionin e tyre. Gjykon mbi rëndësinë e tolerancës mirëkuptimit dhe respektimit të ligjit dhe të drejtave dhe lirive të qytetarit në zgjidhjen e konflikteve.
 - Grupi i katërt: analizon procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian; Gjykon mbi përfitimet që sjell zbatimi i kësaj politike për vendet dhe popujt e mbarë botës dhe jep shembuj mbi politikat e bashkëjetesës paqësore mes popujve, larg konflikteve, duke njohur dhe respektuar dallimet dhe ndryshimet midis tyre.
4. Mësuesi përmbledh parashtrimet e grupeve duke vënë theksin në çështjet kryesore si:
- rolin e bashkimit evropian në bashkëjetesën paqësore midis vendeve dhe popujve;
 - evoluimin e konceptit bashkëjetesë pas vitit 1945 e deri në ditët tona;
 - përpjekjet që bëhen sot jo vetëm nga institucionet e bashkimit evropian, por dhe nga shumë organizata të tjera ndërkombëtare në eliminimin e konflikteve, në ruajtjen e paqes dhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Veprimtaritë e të nxëniet (individuale dhe në grup):

1. Cilat janë konceptet dhe shprehjet që mësuat?
2. Paraqisni në skicë lidhjet midis koncepteve dhe diskutoni në grup shpjegimin dhe argumentimin e këtyre lidhjeve.
3. Parashtroni çështjet kryesore dhe tregoni lidhjet midis tyre dhe temave ndërkurrikulare.
4. Plotësoni përmbajtjen e temës së konceptuar dhe të zhvilluar nga ju.
5. Prezantoni temën mësimore të zhvilluar nga grupi juaj: Përgjigjuni pyetjeve. Mbani shënim për sugjerimet e bëra gjatë prezantimit.
6. Reflektoni për prezantimet e bëra nga të katër grupet. Cilat janë për ju pikat më të forta të secilit prezantim? Mendoni për një variant përbashkues.

Vlerësimi i nxënësit:

- a) Si pjesëtar i grupit sipas rubrikës së vlerësimit të punës në grup:

	Shumë mirë 10 pikë	Mirë 8 pikë	Mesatare 6 Pikë	Mjaftueshëm 5 pikë	Dobët 4 pikë	Vlerësimi
Rolet e grupit						... x 2
Detyrat e grupit						...x 3
Ndërveprimi i grupit						... x 1

Totali i pikëve _____

b) Individualisht, për veprimtaritë e nxënies të kryera prej tij.

VI. METODOLOGJIA PËR ZHVILLIMIN E LËNDËS

Një nga parimet më të vjetra të mësimdhënies është që nxënësit duhet të nxënë vetë. Prandaj, puna e mësuesit nuk qëndron aq shumë në dhënien e njohurive, sesa në ndihmën dhe drejtimin e nxënësve. Mësuesit duhet t'i ndihmojnë nxënësit e tyre që ata të zbulojnë vetë idetë dhe konceptet që fshihen pas faqeve që lexojnë. Në këtë kuadër, rëndësi të veçantë merr ndërveprimi mes mësuesit dhe nxënësve gjatë orës së mësimit. Tashmë është e gjithë pranuar se nxënësit duhet të kenë një rol aktiv gjatë orës së mësimit. Ata duhet të nxiten që të marrin pjesë në mësim duke u kthyer në njëfarë mënyre në “bashkautorë” të mësimdhënie/nxënies. Është detyrë e mësuesi që të gjejë rrugët dhe mjetet e përshtatshme për të bërë të mundur që nxënësit të luajnë rol aktiv gjatë orës së mësimit. Literatura pedagogjike moderne ofron studime dhe rekomandime të shumta lidhur me metodologjinë e mësimdhënies aktive. Disa prej këtyre modeleve paraqiten në vijim.

Model 1

Tema mësimore	Metoda\ teknika
Athina dhe Sparta - dy modele të ndryshme qytet- shteti.	- Ditari trepjesësh - Rrjeti i diskutimit

Nxënësit lexojnë mësimin duke nënvizuar çështjet kryesore. Mësuesi ndërton një tabelë në formën e ditarit tre pjesësh për secilin prej qytet – shteteve që plotësohet nga nxënësit dhe shoqërohet me sqarimet e mësuesit.

Shteti Komenti	Athina	Sparta
Shtrirja gjeografike.	Gadishulli i Atikës	Gadishulli i Peloponezit, krahina e Lakonisë
Veprimtaria ekonomike	Zejtari, tregti, lundrim	Bujqësi
Ndarja shoqërore	1-Eupatridët (aristokratët) 2-Demosi (populli) 3-Metekët (te huajt)	1-Spartanët (aristokracia) 2-Periekët (njerëz të lirë) 3-Iliotët (skllavër të shtetit)
Reformat	1-Drakoni → ligje të rrepta 2-Soloni → ndarje të shoqërisë sipas censit të pasurisë/ hoqi skllavërinë për borxhe/ krijoi helienë dhe këshillin e të katërqindve. 3-Klistheni → bëri reformën administrative (tri krahina dhe 30 rrethe)/ krijoi këshillin e të pesëqindëve/ qytetarët kishin të drejtë të zgjidheshin dhe të zgjidhnin/ vendosi ostakizmin. 4-Perikliu → forcoi ekonominë/ vendosi paga për nënpunësit e shtetit/ vuri në zbatim votimin me short/ ndërtoi vepra publike/ vendosi Eklesinë si organin më të larë qeverisë.	Likurgu → I kushtoi rëndësi edukimit fizik dhe ushtarak, rregullit dhe disiplinës
Sistemi politik	Demokraci-qeverisje e popullit	Oligarki-pushteti i pakicës
Organet qeverisëse	-Eklesia -Bulea	1-Pesë eforët.

	-Helieja -10 strategët -9 Arhondët - Aeropagu (këshilli i pleqve)	2-Herusia (28 anëtarë +dy mbretër). 3-Apela (kuvendi i popullit)
--	--	---


Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësit:

- ✓ njohin shtrirjen gjeografike dhe organizimin politiko –shoqëror të Athinës dhe Spartës;
- ✓ identifikojnë rolin e reformave në thellimin e demokracisë në Athinë;
- ✓ krahasojnë tiparet e jetës ekonomike, politike dhe shoqërore të dy qytet-shteteve antike greke.

Model 2

Tema mësimore	Metoda\ teknika
Reforma protestante.	- Pyetje çelës - Kubimi.

Metoda e kubimit që do të përdoret gjatë kësaj ore mësimi është interesante, sepse ndërthur brenda saj disa veprimtari si p.sh. lexim, mendim kritik, të shkruarit dhe aftësi praktike. Mësuesi ka përgatitur një kuti ne formë kubi (me përmasa të tilla që pas përfundimit të veprimtarisë materiali i shkruar në të, të lexohet qartë nga nxënësit), tabak letre të prera sipas përmasave të faqeve të kubit, ngjitës, lapustila me ngjyra të ndryshme. Kjo metodë realizohet sipas figurës së mëposhtme:



Klasa ndahet në pesë grupe për t'i realizuar me shpejt kërkesat e mësipërme, kërkesa e fundit do të realizohet nga të gjitha grupet nëpërmjet plotësimit të tabakëve të letrës sipas kërkesave që mësuesi ka shkruar në to dhe plotësimit të hartës-skicë e cila mund të jepet si detyrë në shtëpi.

Secila fletë plotësohet si më poshtë nga nxënësit dhe ngjitet në kub pastaj lexohet dhe shpjegohet nga grupet përkatëse. Mësuesi kalon te secili grup duke dhënë orientime.

Fleta I: *Përshkruaj situatën në Evropë në prag të reformacionit:*

- mbretërit e Evropës po kërkonin të largoheshin nga influenca e kishës;
- kisha ishte larguar nga besimtarët dhe synonte përfitime ekonomike (taksat, indulgjencat);
- kisha gëzonte autoritet politik dhe ndërhynte në çështjet shtetërore.

Fleta II : *Argumento faktorët që nxitën Luterin të kundërshtonte kishën dhe shpjego përmbajtjen dhe përhapjen e luteranizmit:*

- Jeta luksoze në selinë papnore/studimi i thellë i biblës
- Përmbajtja e luteranizmit
 - ↗ Individualizmi fetar (vetëm zoti e shpëton njeriun).
 - Parimi i shpëtimit (njeriu shpëton nëpërmjet besimit)
 - ↘ Parimi i shqyrtimit të lirë (besimi duhej të bazohej në leximin e biblës)
- Arsyet e përhapjes së luteranizmit
 - Arsyet politike (konflikti princër- perandor, fshatarë –fisnikë);
 - Paqja e Augsburgut (1555);
- Arsyet fetare (kundërshtitë me kishën-përfitimet ekonomike);

Fleta III : *Analizo shkaqet që çuan në krijimin e kishës Anglikane (liria e besimit)*

- konflikti kishë- mbret në dy kontekste
 - ↗ pakënaqësisë me korrupsionin e kishës
 - ↘
- sundimin nga Roma e largët.
- shkaktari Henri VIII (Konflikti me papën për divorcin)
- ligjet që çuan në krijimin e kishës Anglikane
- ligji i 1533 i cili mohonte autoritetin e papës
- ligji i 1534 i cili nënkuptonte betimin e besnikërisë ndaj mbretit;
- ligjet e 1559 u riorganizua dogma teologjike protestante..... etj.

Fleta IV: *Cili besim fetar është krijuar përveç protestanizmit si rrjedhim i shkëputjes nga kisha katolike? Gjeni ngjashmëritë.*


- todoksizmi si dhe protestanizmi u mbështetën në doktrinën e krishterë;
- ndikuan në ngushtimin e terrenit të kishës katolike në Evropë;

Fleta V: *Krahaso luteranët me kalvinistët dhe anglikanët, nxirr të përbashkëtat. (Mund të ndërtohet Diagrami i Venit)*

- ishin kundër katolicizmit
kundër korrupsionit, abuzimit të kishës,
ishin për një kishë të thjeshtë

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:


- ✓ përshkruan situatën në Evropë në prag të Reformacionit;
- ✓ shpjegon rrethanat historike që nxitën lëvizjen reformatore brenda kishës katolike;
- ✓ analizon arsyet e krijimit të kishës protestante;
- ✓ vlerëson ndikimin e Reformacionit në vendet evropiane.



Model 3.

Tema mësimore	Metoda\ teknika
Revolucioni industrial dhe ndikimi i tij në shoqërinë Evropiane	- Stuhi mendimesh - INSERT

Mësuesi shkruan në tabelë “Revolucion industrial” dhe kërkon nga nxënësit të thonë se çfarë kuptojnë me të.



Mësuesi udhëzon të lexohet mësimi duke plotësuar secili në fletore tabelën që do të ndërtojë në dërrasë. Pas leximit, nxënës të ndryshëm marrin pjesë në plotësimin e tabelës të ndërtuar nga mësuesi.

✓	+	-	?
Informacion i njohur	Informacion i ri	Informacion që dihej ndryshe	Informacion shtesë
1. Revolucion 2. Anglia vendi ku filloi Revolucioni 3. U bënë shpikje të reja.	Revolucioni industrial(shekulli XVIII-XIX) solli: - ndryshime thelbësore në mënyrën e jetesës së njerëzve; - në mënyrën e organizimit të prodhimit. Arsyet që Revolucioni filloi në Angli - Anglia kishte krah të lirë pune (Gardhimi) - Kishte pasuri nëntokësore (hekur, qymyr) - Zotëronte tregun në koloni dhe kontinent. - Kishte një flotë të fuqishme tregtare. - Kishte kapitalin e nevojshëm që nevojitej për financim. - Rrjeti lumor dhe transporti ndihmuan në komunikim. Shpikje të rëndësishme - Faza e I: Në industrinë tekstile:çikriku fluturues Xhon Kej.(1733), Makina Xheni (1764), tezgjahu	Nxënësit mund të mos dinë: - Si u zhvillua gardhimi? - Revolucioni Industrial u parapri nga ai bujqësor	- Cilat ishin ndryshimet në tregun botëror pas revolucionit industrial? - Si e pritën punëtorët përdorimin e makinave? <i>(Mësuesi mund të tregojë për Lëvizjen Ludiste)</i>

	mekanik, makina për zhveshjen e pambukut etj. - Faza II:Në transport: motori, lokomotiva, anija me avull. Revolucioni i dytë industrial (fundi i shekullit XIX-shekulli XX) - nënkupton kalimin drejt shoqërisë industriale - triumfin e revolucionit shkencor - u zbuluan burime të reja energjie si nafta, gazi natyror, elektriciteti. - u zhvilluan degë të industrisë si:industria metalurgjike, kimike, elektrike etj. Pasojat e revolucionit industrial: - U zhvillua klasa borgjeze, proletariati i ri qytetar. - Rritje të jashtëzakonshme të qyteteve. - Ndryshoi struktura e popullsisë rritje të popullsisë urbane. - Ndikimi në rritje i doktrinës së liberalizmit ekonomik. - Ndarja e botës në dy hapësira të mëdha: vendet që		
--	---	--	--

	zotëronin koloni dhe vendet koloniale.		
--	--	--	--

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ përkufizon konceptin revolucion industrial;
- ✓ shpjegon arsyet pse revolucioni industrial i ka filluar në Angli;
- ✓ identifikon shpikjet e reja dhe degët e industrisë që njohën zhvillim gjatë dy revolucioneve industriale;
- ✓ analizon pasojat e Revolucionit Industrial.

Model 4

Tema mësimore	Metoda\ teknika
Veprimtari praktike: Jeta në Evropë në shekulli XVI-XVII	- Diskutim - Punë në grupe

Sugjerohet që kjo orë mësimi të zhvillohet në kabinetin e informatikës ku nxënësve t'u jepet mundësia të përdorin kompjuterin, internetin për të kërkuar dhe hulumtuar informacion rreth temës së dhënë.

- Ora e veprimtarisë praktike do të zhvillohet në dy faza:

FAZA E PARË: Diskutim

Mësuesi organizon nxënësit të marrin pjesë në diskutim nëpërmjet pyetjeve:

- Si ndryshon jeta e evropianëve në fillimet e epokës moderne?
- Ku jetojnë?
- Si e sigurojnë jetesën?
- Çfarë ushqimesh konsumojnë?
- A arsimohen dhe si?
- Si është higjiena e tyre personale?
- A kanë kohë të lirë dhe si e kalojnë atë?
- Cilat ishin ndryshimet në qytetet e kësaj periudhe?
 - Numri i popullsisë.
 - Organizimi urban.

- Qytetet si qendra konsumi dhe tregtie.
- Qyteti dhe borgjezia, një binom i pandashëm.
- A ka risi në kuadrin e organizimit shoqëror-ekonomik?
- Cilat janë zhvillimet në kulturë?
 - Veprat dhe përfaqësuesit kryesorë në letërsi.
 - Rrymat në art dhe arkitekturë, si dhe përfaqësuesit kryesorë të tyre.

FAZA E DYTË: Punë në grupe

Mësuesi e ndan klasën në dy grupe dhe cakton detyrat për secilin grup si më poshtë:

Grupi i parë:

- Grumbulloni të dhëna për jetën e një familjeje fisnike;
- Evidentoni rëndësinë e përkatësisë klasore në aspekte të ndryshme të mënyrës së jetesës;
- Ndërtoni atë në klasë.

Grupi i dytë:

- Grumbulloni të dhëna për jetën e një familjeje fshatare;
- Evidentoni rëndësinë e përkatësisë klasore në aspekte të ndryshme të mënyrës së jetesës;
- Ndërtoni një paraqitje skematike dhe prezantoni atë në klasë;

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ identifikon tipare të jetës dhe shoqërisë në shekulli XVI-XVII;
- ✓ krahason pozitën e shtresave të ndryshme shoqërore;
- ✓ evidenton arritjet në art, letërsi, arkitekturë dhe përfaqësuesit kryesorë të tyre.

Model 5

Tema mësimore	Metoda\ teknika
Ekonomia socialiste dhe tiparet e saj.	- Diskutim - Pyetje –përgjigje - Hartë e mendimit

Mësuesi udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin rreth 10 minuta dhe ndërkohë shkruan në tabelë pyetjet të cilat nxënësit do i përgjigjen lidhur me informacionin e ri:

- Cilat ishin bazat ekonomike të Shqipërisë në vitin 1945?
- Ku mbështetej shteti komunist nga pikëpamja e pronës?

- Cili ishte qëndrimi i regjimit ndaj investimeve të huaja?
- A mendoni se procesi i zhvillimit të industrisë së rëndë ishte i përshtatshëm për zhvillimin e Shqipërisë?
- Cili ishte vendi i bujqësisë në strukturën ekonomike të Shqipërisë socialiste?
- A mendoni se Reforma Agrare e vitit 1946 ishte një politikë afatgjatë apo thjesht një masë e përkohshme?
- Cili ishte kuptimi i planeve pesëvjeçare dhe drejtimit të centralizuar të ekonomisë socialiste?

Pasi nxënësit u përgjigjen pyetjeve mësuesi bën një përsëritje të koncepteve duke ndërtuar skemën në tabelë.

Qëndrimi ndaj pronës - kundër pronës private për arsye ideologjike (element kapitalist); - kundër investimeve të huaja nga ana e kapitalit privat e shtetëror. - baza e pronës është ajo shtetërore;	Fshati socialist - reforma agrare si hap i përkohshëm; - kolektivizimi i bujqësisë si zgjedhje strategjike për zhvillimin e bujqësisë; - modelet e zbatuara në procesin e kolektivizimit; - rrugët e ndjekura në këtë proces;
<i>Ekonomia socialiste</i>	
Organizimi ekonomik - industria e rëndë si bazë e zhvillimit të ekonomisë; - drejtimi nëpërmjet planifikimit të centralizuar; - shteti përcakton zhvillimin e degëve të ekonomisë; - planet 5-vjeçare; - aspektet positive dhe negative të industrializimit.	Modeli i ekonomisë së centralizuar - vendimmarrje qendrore për ekonominë; - planifikim i thellë në nivel makro dhe mikro-ekonomik; - eliminim thuajse i plotë i iniciativës private në ekonomi;

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ evidenton drejtimet kryesore të zhvillimit të ekonomisë socialiste;

- ✓ analizon thelbin e drejtimit të ekonomisë në mënyrë të centralizuar;
- ✓ tregon qëndrimin e shtetit komunist ndaj pronës private në qytet dhe fshat;
- ✓ argumenton, sipas mendimit të tij, arritjet dhe të metat e ekonomisë së planifikuar dhe centralizuar.

Model 6 “Të mësuarit nëpërmjet veprimtarive praktike”

Për secilën tematikë të dhënë në program janë parashikuar dhe orë për veprimtari/projekte, të cilat jepen në rubrikën “Veprimtari praktike”. Nëpërmjet këtyre veprimtarive, mësuesi nxit zhvillimin, përdorimin dhe demonstrimin e koncepteve dhe kompetencave historike. Në orët e veprimtarive nxënësi zbaton në situata konkrete dhe praktike kompetencat e lëndës dhe kompetencat kyçe. Në këto orë nxënësi kërkon aspekte për historinë e qytetërimeve në antikitet, në mesjetë, në periudhën moderne dhe në periudhën bashkëkohore për vendin, Evropën dhe më gjerë për të kuptuar se si ngjarjet lidhen me një kontekst të gjerë historik. Duke bërë kërkime mbi historinë e qytetërimeve në antikitet, në mesjetë, në periudhën moderne dhe në periudhën bashkëkohore, nxënësit i krijojnë mundësinë të përdorin burimet për të kuptuar lidhjet e brendshme e të jashtme midis ngjarjeve, periudhave dhe shoqërive të ndryshme, marrëdhëniet shkak-pasojë, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimet botërore, duke krijuar te nxënësi bindjen se qytetërimet e sotme janë një vazhdimësi progresive e qytetërimeve të hershme, pra e sotmja e ka burimin tek e kaluara dhe është e lidhur me të.

- Shqyrton rrugët në të cilat e kaluara i ka ndihmuar të formojnë identitetin, kulturat e përbashkëta, vlerat dhe qëndrimet sot. Kjo përfshin: eksplorimin e marrëdhëniet në mes të kaluarës dhe të tashmës, të kuptuarit që idetë, vlerat, besimet rrjedhin nga një proces ndryshimi dhe ndërveprimi i vazhdueshëm, duke vlerësuar atë që njerëzit brenda një kulture kanë të përbashkët, si dhe diversitetin e tyre, duke vlerësuar se kulturat janë gjithmonë në ndryshim si rezultat i kontaktit me kulturat e tjera. Duke studiuar rrugët në të cilat e kaluara ndihmon për të formuar identitetet, kulturat e përbashkëta, vlerat dhe qëndrimet sot, nxënësit përgatiten për jetën në një shoqëri të ndryshme dhe me shumë etni, në një botë gjithnjë e më të ndërruar.
- Vlerëson përmes vizitave ku është e mundur rolin e muzeve, galerive, arkivave historike në ruajtjen dhe paraqitjen e së shkuarës. Kjo përfshin përdorimin e muzeve, galerive, arkivave dhe vende historike për të gjeneruar dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve rreth të shkuarës dhe për

të ngjallur interesin e nxënësve, në mënyrë që ata në jetën e tyre përtej shkollës, të vazhdojnë përdorimin e këtyre burimeve.

- Përdor TIK-un për të kërkuar informacion për të shkuarën në lidhje me datat, personazhet, objektet, ngjarjet dhe proceset historike, si dhe për të përzgjedhur, klasifikuar, organizuar dhe paraqitur gjetjet. Kjo përfshin: vlerësimin e faqeve të internetit, duke marrë parasysh prejardhjen e materialeve dhe duke vlerësuar vlerën e tyre, si dhe përdorimin e TIK-ut për të kërkuar të dhëna historike, për të përzgjedhur, për të klasifikuar, për të organizuar dhe për të prezantuar informacionin.

Tema mësimore	Metoda\ teknika
Veprimtari praktike: Despotati i Epirit	- Punë në grupe - Përgatitje e një posterit

Mësuesi shpjegon si u krijua shteti i Epirit dhe nga kush drejtohej ai (mund t'i referohet situatës së të nxënësve në tekst ose materiale të tjera shtesë). Nxënësit janë ndarë në grupe që në orën paraardhëse dhe janë përgatitur për veprimtarinë praktike sipas detyrave të caktuara më poshtë.

Grupi I: Formimi i shtetit të Despotatit të Epirit

- Rrethanat historike të krijimit dhe fillimeve të despotatit
- Shtrirja territoriale e tij
- Marrëdhëniet e despotatit me shtetet e tjera rivale të së njëjtës periudhë

Grupi II: Shqiptarët dhe Despotati i Epirit

- Marrëdhëniet mes popullsisë shqiptare dhe sundimtarëve të despotatit
- Autonomia e shqiptarëve në kuadër të despotatit
- Marrëdhëniet e elementit shqiptar me grupet e tjera etnike që përbënin popullsinë e despotatit

Grupi III: Faktorët e shkatërrimit të Despotatit të Epirit

- Roli i Despotatit të Epirit në përpjekjet për ringritjen e Perandorisë Bizantine
- Konfliktet e despotatit me shtete të tjera sidomos me Perandorinë bullgare dhe atë të Nikesë
- Ndikimi i pakënaqësive të shqiptarëve në rënien e despotatit dhe situata e tyre nën sundimin e ri bizantin

Mësuesi e organizon orën e mësimin në dy pjesë.

Pjesa I (20 min.) – Organizohet në klasë diskutim rreth materialeve të sjella nga nxënësit sipas çështjeve përkatëse.

Pjesa II (20 min.) - Organizohen nxënësit për përgatitjen e një posteri ku të pasqyrohen aspektet e ndryshme të historisë së Despotatit të Epirit.

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ shpjegon rrethanat historike të krijimit të Despotatit të Epirit;
- ✓ identifikon kufijtë e tij në periudha të ndryshme;
- ✓ vlerëson rolin e familjes së Engjëllorëve në krijimin e Despotatit të Epirit;
- ✓ analizon rolin e elementit shqiptar në jetën e brendshme të Despotatit dhe në konfliktet me formacione të tjera shtetërore konkurrense;
- ✓ analizon faktorët e rënies së Despotatit dhe situatën e popullsisë shqiptare.

VII. PLANIFIKIMI I LËNDËS DHE MODELE TË PLANIFIKIMIT LËNDOR

Planifikimi është një proces i rëndësishëm i zbatimit të kurrikulës, i cili i krijon mundësinë mësuesit të jetë krijues dhe i lirë në procesin e mësimdhënies. Për një planifikim të mirë, mësuesi duhet të njohë dokumentet e mëposhtme:

- Kornizën Kurrikulare;
- Kurrikulën bërthamë;
- Programin mësimor.

Baza e një planifikimi të suksesshëm është njohja e mirë e programit mësimor lëndor. Mësuesi duhet të zbatojë me përpikmëri të gjitha kërkesat e këtij programi. Rezultatet e të nxënit janë një themel i përbashkët për të gjithë mësuesit. Ata përzgjedhin vetë metodat dhe strategjitë më të përshtatshme, burimet e mundshme për t'u shfrytëzuar, llojet dhe mjetet e vlerësimit.

7.1. Llojet e planifikimeve

Planifikimi i mësimdhënies për lëndën e historisë përfshin:

- planifikimin vjetor;
- planifikimin për secilën periudhë;
- planifikimin ditor.

Në fillim të vitit shkollor mësuesi duhet të dorëzojë pranë drejtorisë së shkollës *planin vjetor* të lëndës, i cili shërben si një kornizë e ndarjes së përgjithshme të përmbajtjes lëndore dhe të orëve mësimore, si edhe *planin e periudhës së parë* (shtator- dhjetor). Planet e periudhës së dytë dhe të tretë dorëzohen para fillimit të secilës periudhë.

Gjatë vitit, sipas rrethanave që i krijohen, mësuesi mund të bëjë ndryshime në planin fillestar mësimor. Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë nga sa e ka parashikuar, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi. Në këtë mënyrë mësuesi planifikon duke u bazuar në përparimin e nxënësve dhe në vështirësitë e hasura në periudhat paraardhëse, duke u përqendruar te arritjet e kompetencave kyçe dhe të lëndës.

7.2. Planifikimi vjetor i lëndës

Për planifikimin vjetor të lëndës, mësuesi, përveç programit mësimor duhet të njohë edhe tekstin që ka përzgjedhur për atë vit shkollor. Natyrisht, realizimi i programit është qëllimi i vërtetë i mësuesit, kurse teksti mësimor i përzgjedhur është një mjet për ta përmbushur këtë qëllim. Kur mësuesi sheh se teksti nuk i ka dhënë vendin e mjaftueshëm përvetësimit të një rezultati të nxëni të programit, ai e plotëson vetë këtë mungesë të tekstit, duke përdorur burime të tjera të nxëni.

Plani vjetor është një plan sintetik. Mësuesi planifikon orët dhe përmbajtjen kryesore lëndore për tri periudha. Periudhat janë:

- periudha e parë: shtator- dhjetor;
- periudha e dytë: janar - mars;
- periudha e tretë: prill- qershor.

Periudhat nuk janë semestra, por janë periudha reflektimi për mësuesit dhe nxënësit duke reflektuar mbi punën dhe rezultatet e tyre dhe si mund të përmirësohet në vazhdim.

7.3. Model planifikimi vjetor

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI

LËNDA: HISTORI

KLASA: 11

72 ORË

Tabela: Model planifikimi vjetor në lëndën e historisë

Tematikat	Shpërndarja e përmbajtjes lëndore për realizimin e kompetencave		
	Shtator – Dhjetor 26 orë	Janar - Mars 24 orë	Prill - Qershor 22 orë
I.Parahistoria dhe antikiteti në territoret shqiptare (9 orë)	Periudha parahistorike Gjurmë të parahistorisë në territoret shqiptare, Qytetërimi ilir	Shqiptarët dhe osmanët (vazhdim) Shqiptarët në periudhën e tanzimatit, Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe veprimtaria e saj	Vendosja e regjimit komunist në Shqipëri 1944-1990 (vendosja e regjimit komunist në Shqipëri, Shqipëria gjatë viteve 1944-1948, ndërtimi i partisë-shtet në Shqipëri, sipas modelit stalinist (1948-1953), Shqipëria gjatë viteve 1954-1961, Shqipëria gjatë viteve 1961-1978,vet izolimi i shtetit shqiptar dhe kriza e regjimit komunist (1978-1990),
II.Territoret shqiptare në mesjetë (6 orë)	Ilirët: prejardhja dhe shtrirja territoriale e tyre. jeta ekonomike e shoqërore e ilirëve, shteti ilir, shteti i Epirit, mbretëria dardane, konfliktet iliro-romake, burimet e shkruara greke dhe romake për qytetërimin ilir.	Rilindja Kombëtare Shqiptare Përpyjekjet e shqiptarëve për gjuhë dhe për shkollë shqipe gjatë shekullit XIX, xhonturqit dhe shqiptarët, kuvendi i Vlorës dhe shpallja e pavarësisë së Shqipërisë, roli i diasporës në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare.	Shqipëria gjatë viteve 1944-1948, ndërtimi i partisë-shtet në Shqipëri, sipas modelit stalinist (1948-1953), Shqipëria gjatë viteve 1954-1961, Shqipëria gjatë viteve 1961-1978,vet izolimi i shtetit shqiptar dhe kriza e regjimit komunist (1978-1990),
III. Shqiptarët në fund të shek. XIV – fillimin e shek. XX (13 orë –vazhdon periudhën e dytë)	Territoret shqiptare në Mesjetë Mesjeta e hershme		Shqipëria gjatë viteve 1945-1990,jeta e përditshme në Shqipërinë komuniste, opozitarët e regjimit komunist)
IV.Sfidat e shtetit të pavarur	arbërore, vazhdimësia etno kulturore, Arbëria midis Lindjes dhe Perëndimit		

shqiptar (1912-1939) (12 orë) V.Shqiptarët dhe Lufta e Dytë Botërore (1939-1944) (8 orë) VI.Shqipëria gjatë regjimit komunist (1945-1990) (11 orë) VII. Rënia e regjimit komunist. Fitorja e demokracisë	(zhvillimet politike në shek. XI-XIV), Despotati i Epirit, ekonomia dhe shoqëria në qytetin dhe fshatin mesjetar arbëror, organizimi politik në Arbërinë e shek. XIV-XV, arti, kultura, letërsia, arsimi dhe besimi në Arbërinë mesjetare. Shqiptarët dhe osmanët Ardhja e osmanëve në Ballkan dhe qëndresa ballkano-arbërore (fundi i XIV-fillimi i shek. XV), Gjergj Kastriot Skënderbeu dhe Besëlidhja e Lezhës, qëndresa e shqiptarëve kundër osmanëve dhe diplomacia e shtetit të Skënderbeut, figura e Gjergj Kastriot Skënderbeut përmes letërsisë dhe artit shqiptar e botëror, territoret shqiptare gjatë sundimit osman (shek. XVI-XVIII), Pashallëku i Shkodrës, Pashallëku i Janinës, arsimi dhe kultura në shek. XVI-XVII, Rilindja	Sfidat e shtetit të pavarur shqiptar 1912-1939 (shteti shqiptar në vitet 1912- 1914,Shqipëria gjatë Luftës së Parë Botërore (1914-1918), Konferenca e Paqes dhe Kongresi i Lushnjës, shqiptarët e Kosovës, Çamërisë dhe viseve të tjera, republika shqiptare, monarkia shqiptare në vitet 1928- 1939, lëvizjet politiko- shoqërore në Shqipëri në vitet në vitet 1925- 1939 Lufta e Dytë Botërore 1939-1944 Shqipëria nën pushtimin fashist italian, rritja e lëvizjes antifashiste në Shqipëri, Shqipëria nën pushtimin gjerman dhe qëndresa shqiptare,shqiptarët e Kosovës dhe te Çamërisë gjatë Luftës	Rënia e regjimit komunist dhe fitorja e demokracisë Lëvizja kundër regjimit komunist, reformat demokratike, integrimi në institucionet euro-atlantike, shpallja e pavarësisë së Kosovës.
---	---	---	---

	Kombëtare dhe tiparet e programit politik të rilindësve shqiptarë	II Botërore, hebrenjtë dhe shqiptarë në Luftën e Dytë Botërore, çlirimi i vendit dhe pasojat e luftës.	
--	---	--	--

7.4 Planifikimi i periudhës

Planifikimi i periudhës është një planifikim më afatshkurtër dhe më i detajuar i mësimdhënies. Ai është analitik dhe në të detajohen temat mësimore që do të zhvillohen përgjatë saj. Mësuesi harton planifikimin e periudhës përkatëse në fillim të saj dhe e dorëzon në drejtorinë e shkollës para fillimit të periudhës. Ky plan hartohet duke iu përmbajtur programit dhe tekstit mësimor përkatës. Në planet sipas periudhave planifikohen të gjitha orët. Mësuesit janë të lirë të bëjnë ndryshimet e tyre hap pas hapi në varësi të specifikave të lëndës së tyre.

Ky lloj planifikimi kërkon që mësuesi të përcaktojë me kujdes:

a) Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe

Në këtë rubrikë mësuesi do të vendosë rezultatet e të nxënësve të kompetencave kyçe, të cilat do të zhvillohen nga nxënësit përgjatë temave mësimore, të zhvilluara gjatë kësaj periudhe. Mësuesi i përzgjedh këto rezultate në programin mësimor, te rubrika “Rezultatet kryesore të të nxënësve, sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së ...”.

b) Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të lëndës

Në këtë rubrikë vendosen rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të lëndës, të cilat do të arrihen nga nxënësi nëpërmjet zhvillimit të këtyre temave mësimore. Mësuesi i përzgjedh këto rezultate të nxënësve nga programi mësimor sipas tematikave të përmbajtjes së lëndës.

c) Numrin rendor

Këtu vendosen numrat për temat mësimore. Totali i numrave në planin e periudhës përkon me numrin e orëve që janë përcaktuar në planin vjetor të lëndës ose të modulit.

d) Tematikat

Në këtë rubrikë shënohen tematikat/kapitujt mbi të cilat është ndërtuar teksti i lëndës.

e) Temat mësimore

Në këtë rubrikë shënohen të gjitha temat mësimore që do të zhvillohen gjatë periudhës. Kjo rubrikë përmban:

Orë të detyruara për t'u planifikuar:

- temat mësimore brenda të cilave do të realizohen rezultatet e të nxënit. Mësuesi orientohet sipas tekstit mësimor;
- orët e veprimtarive praktike që do të zhvillojë mësuesi për zbatimin dhe demonstrimin e aftësive të fituara në lëndën e historisë si dhe për zhvillimin e kompetencave të lëndës e kompetencave kyçe.
- orët e projektit kurrikular që do të zhvillojë mësuesi për zbatimin dhe demonstrimin e aftësive të fituara në lëndën e historisë si dhe për zhvillimin e kompetencave të lëndës e kompetencave kyç.
- orët e testeve përmblendhëse për të matur njohuritë e fituara nga nxënësit në periudhën përkatëse. Mësuesi planifikon 3 teste përmblendhëse, nga një për çdo periudhë. Testet përmblendhëse planifikohen kur mësuesi e shikon të arsyeshme kohën e zhvillimit të tyre, d.m.th jo detyrimisht në fund të periudhës, por edhe disa javë përpara se të mbarojë periudha.

f) Situata e të nxënit

Në këtë rubrikë vendosen situatat e të nxënit që mësuesi parashikon të realizojë gjatë periudhës, të cilat mund të ndryshohen dhe plotësohen përgjatë zhvillimit të lëndës. Situatat e të nxënit mund t'i përkasin një teme mësimore, disa temave mësimore, ashtu sikurse mund të ketë tema mësimore për të cilat mësuesi nuk zhvillon situata të nxëni. Me situatë të nxëni kuptohet ndërtimi i njohurive nëpërmjet një situatë praktike ose reale si pjesë e metodologjisë dhe organizimit të klasës.

g) Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Në këtë rubrikë mësuesi vendos teknikat dhe metodat e mësimdhënies (p.sh., harta e konceptit, parashikimi me terma paraprakë, grupet e ekspertëve, punë në grup etj.) që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar (jo shumë e detajuar, sepse e tillë kjo rubrikë detajohet në planifikimin ditor).

h) Vlerësimi

Këtu vendosen teknikat e vlerësimit që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar si p.sh., vlerësimi i përgjigjeve me gojë; vlerësimi i punës në grup; vlerësim mes nxënësish; vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në klasë; vlerësim i detyrave të shtëpisë; vlerësim i veprimtarisë praktike, vetëvlerësim; intervistë me një listë treguesish; vëzhgim me një listë të plotë treguesish; prezantim ose punë me gojë ose me shkrim, projekt kurrikular etj. Kjo rubrikë nuk detajohet shumë, sepse është e detajuar në planifikimin ditor.

i) Burimet

Në këtë rubrikë mësuesi vendos burimet që do të përdoren për arritjen e rezultateve të të nxënës si p.sh., teksti i nxënësit, teksti i ushtrimeve (nëse ka të tillë), materiale të përgatitura nga mësuesi ose nxënësi etj. Kjo rubrikë nuk plotësohet në mënyrë shumë të detajuar, pasi e tillë do të plotësohet në planifikimin ditor.

7.5. Model planifikimi për një periudhë

Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe				
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: shqyrton, analizon, parashtron pyetje për të argumentuar, diskutuar dhe komunikuar informacionin historik si dhe konceptet dhe idetë historike.				
Përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë, për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.				
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave historike				
Kërkimi historik: identifikon dhe shqyrton individualisht dhe si pjesë e një grupi, pyetje specifike historike ose çështje, duke bërë testimin e hipotezave dhe reflekton në mënyrë kritike për pyetje ose çështje historike.				
Nr.	Tematika	Organizimi i temave me dy orë të njëpasnjëshme	Temat mësimore	
1		Periudha parahistorike	Periudha parahistorike	
2		Qytetërimi ilir	Qytetërimi ilir	
3		Mbretëritë ilire	Mbretëritë ilire	
4		Shteti i Epirit	Shteti i Epirit	
.....				
11		Territoret shqiptare në Mesjetë	Territoret shqiptare gjatë Mesjetës së Hershme (shek. V–X)	

12			Zhvillimi ekonomik dhe shoqëror në fshatin e qytetin mesjetar (shek. X-XIV)	
13		Veprimtari praktike	Veprimtari shkollor	
14			Veprimtari shkollor (<i>Projekt shkollor ose konkurs në rang shkolle ose ekskursion etj.</i>)	
17		Përsëritje		
20				
22		Test përmblendhës	Test përmblendhës – Periudha e parë	
23				
24		Projekti kurrikular	Projekt (1) ²	
25			Projekt (2)	
26		Rilindja Kombëtare dhe tiparet e programit politik të rilindësve shqiptarë		

²Orët e projektit zhvillohen edhe të shpërndara në të tri periudhat. Në varësitë mundësive dhe fleksibilitetit që ka, mësuesi mund të planifikojë 1-2 orë projekti kurrikular, për secilën periudhë.

7.6. Planifikimi ditor

Mësuesi planifikon çdo orë mësimore. Në ndryshim nga planifikimi tradicional, në planifikimin e kurrikulës me kompetenca kemi këto ndryshime:

Planifikimi (tradicional) i orës së mësimit	Planifikimi bazuar në kompetenca i orës së mësimit
Në planifikim përcaktohet çfarë bën mësuesi për të realizuar mësimin.	Në planifikim përcaktohet çfarë bëjnë nxënësit ndërsa realizohet mësimi (situatat, veprimtaritë, detyrat).
Mësimi përqendrohet pothuajse te përmbajtja.	Mësimi përqendrohet mbi proceset dhe veprimtaritë.
Mësimi pritet të ketë të njëjtin organizim të orës së mësimit gjithmonë.	Mësimi nuk ka të njëjtën metodologji gjithmonë. Organizimi varet nga rezultatet që duam të arrijmë.
Roli i mësuesit është kryesisht ligjërues (shpjegon).	Roli i mësuesit është organizator duke mbizotëruar dhe duke e vënë theksin të bashkëveprimi i nxënësve.

7.7. Model i planifikimit të orës mësimore

Plan ditor për orë mësimore 45 minuta				
Klasa	Fusha	Lënda	Tema mësimore	Situata e të nxënit
11	Shoqëria dhe mjedisi	Histori	Ardhja e osmanëve në Ballkan dhe qëndresa ballkano arbërore (fundi i shekullit XIV – fillimi i shekullit XV)	Mësuesi e nis orën e mësimit me një prezantim të principatës së Kastriotëve dhe Arianitëve. Shiko: https://www.youtube.com/watch?v=y2aC2PM5-gQ
Rezultatet e të nxënit Nxënësi: - përcakton arsyet e ardhjes së osmanëve në Ballkan dhe territoret shqiptare; - evidenton përpjekjet e ballkanasve për qëndresë ndaj osmanëve; - shpjegon format e para të qëndresës në territoret shqiptare;				

- zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë (*Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit*);
- zhvillon aftësitë e të menduarit për realizimin e kërkimit historik (*Kompetenca e të menduarit*);
- zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të shprehurit trashëgiminë materiale dhe shpirtërore (*Kompetenca e të nxënit*).

Fjalët kyçe	Burimet	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare	Metodologjia
vasalitet. koalicioni ballkanik, osmanëve sanxhak. principatë, kryengritje	Libri i nxënësit , interneti,botime të ndryshme, enciklopedi ,hartë e principatave të shekullit XIV, hartë të pushtimeve të para osmane etj.	Gjeografinë Letërsinë	Bashkëbisedim/ mësimdhënie e ndërsjelltë

Organizimi i orës së mësimi

Mësuesi e nis orën e mësimi me një prezantim të principatave kryesore të shekullit XIV në Arbëri duke u përqendruar te ajo e Kastriotëve dhe e Arianitëve.

Shikoni: <https://www.youtube.com/watch?v=y2aC2PM5-gQ>

Pasi ndjekin prezantimin, mësuesi organizon një bashkëbisedim me nxënësit duke rikujtuar njohuri nga temat e mëparshme si dhe njohuri të mësuara në klasën e 10-të mbi Perandorinë Osmane p.sh.:

Cilat ishin principatat kryesore në vendin tonë?

Nga kush drejtoheshin?

Cilat ishin ato tipare që tregojnë për organizimin e tyre si dhe shtetet e tjera të Mesjetës?

Kur u krijua shteti osman?

Ku shtrihej ai në periudhën e lulëzimit të tij?

Kujtoni se cilat ishin arsyet që osmanët pushtuan lehtë Ballkanin?


Ndërtimi i njohurive

Mësuesi e ndan klasën në grupe sipas pjesëve të mësimit dhe udhëzon të lexohet mësimi.

Nga secili grup mësuesi cakton një nxënës i cili do të luajë rolin e mësuesit. Detyra e tij është të shpjegojë përmbajtjen e mësimit, të shpjegojë paqartësitë e nxënësve të tjerë si dhe të drejtojë pyetje për nxënësit e grupit për të kontrolluar nëse është kuptuar mësimi.

Grupi i parë	Grupi i dytë	Grupi i tretë
Qëndrimi i klasës feudale ballkanike dhe shqiptare ndaj osmanëve.	Koalicione ballkanike.	Ndarja e tokave shqiptare

Mësuesi tregon kujdes që të mos ngelen informacione të mësimit pa u shpjeguar për këtë arsye në përfundim të veprimtarisë ndërton njohuritë e reja në mënyrë të përmbledhur në tabelë.



Pyetje për diskutim

Mësuesi nxit të menduarit kritik të nxënësve duke drejtuar kërkesën:

Duke vështruar në hartë shtrirjen e principatës së Gjon Kastriotit evidentoni faktet që dëshmojnë se kjo principatë kishte potencial ekonomik.

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi:

- analizon shkaqet e përparimit të shpejtë të osmanëve në Ballkan;
- shpjegon pjesëmarrjen e gjerë të shqiptarëve në koalicionin e 1389-ës;
- evidenton copëtimin e tokave shqiptare;
- analizon politikën e Gjon Kastriotit dhe Gjergj Arianitit kundrejt osmanëve.

Vlerësimi:

Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna në formulimin e pyetjeve, në të menduarit kritik dhe në arritjen e kompetencave.

Niveli 2:

- Liston betejat e ndryshme mes osmanëve dhe popujve ballkanikë.
- Evidenton në hartë përparimin e osmanëve në Gadishullin Ballkanik.
- Dallon ndarjen e tokave shqiptare në fundshekullin XIV – fillimin e shekullin XV).
- Tregon ngjarjet kryesore të rezistencës shqiptare ndaj osmanëve.

Niveli 3:

- Shpjegon fazat e ndryshme të pushtimeve osmane në Ballkan.
- Analizon shkaqet e suksesit të osmanëve në Ballkan.
- Shpjegon organizimet e koalicioneve ballkanase kundër pushtimit osman.

Niveli 4:

- Bën lidhjen mes situatës së brendshme të shteteve ballkanike dhe qëndresës antiosmane.
- Vlerëson qëndrimin e klasës sunduese ballkanike përkundrejt pushtuesve osmanë.
- Interpretton faktet dhe prezanton punën e bërë individualisht apo në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Rendit koalicionet ballkanike dhe pjesëmarrësit e tyre si dhe përparimin e osmanëve në Ballkan duke ndërtuar hartën e Ballkanit ku të paraqiten me ngjyra të ndryshme pushtimet e realizuara pas çdo koalicioni.

Plan ditor për orë mësimore 90 minuta				
Klasa	Fusha	Lënda	Tema mësimore	Situata e të nxënit
11	Shoqëria dhe mjedisi	Histori	Shqipëria nën pushtimin fashist italian Rritja e lëvizjes antifashiste në Shqipëri (1941-shtator 1943)	Mësuesi, për të nxitur kureshtjen e nxënësve shfaq në monitor sekuenca mbi pushtimin fashist italian në Shqipëri dhe Konferencën e Mukjes: https://www.youtube.com/watch?v=RTk0tunwtYs https://www.youtube.com/watch?v=f5wkXeimzag Mësuesi nxit kureshtjen e nxënësve duke drejtuar pyetje dhe organizuar diskutimin në klasë.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Nxënësi:

përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.

Kompetenca e të menduarit. Nxënësi:

përdor mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. Nxënësi:

diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e të tashmes dhe perspektivat e të ardhmes

Kompetenca personale. Nxënësi:

përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi:

- evidenton situatën e marrëdhënieve italo-shqiptare në prag të pushtimit fashist të Shqipërisë dhe përpjekjet e mbretit Zog për gjetjen e një rrugëdaljeje;

- tregon dinamikën e pushtimit dhe rezistencën e shqiptarëve ndaj tij;
- shpjegon ndryshimet kushtetuese, në organizimin shtetëror dhe ekonomi pas pushtimit të Shqipërisë;
- evidenton format e rezistencës antifashiste në Shqipëri;
- analizon procesin e formimit të forcave politike të organizuara me karakter antifashist;
- shpjegon të përbashkëtat dhe dallimet mes forcave të ndryshme politike antifashiste në Shqipëri;
- argumenton arsyet e thirrjes së Konferencës së Mukjes dhe qëndrimin e Partisë Komuniste ndaj saj.

Fjalët kyçe	Burimet	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare	Metodologjia
bashkim personal fashistizim i shkollës trakte akte sabotimi Mujo Ulqinaku internim zogist nacionalist Komintern Front Antifashist Nacionalçlirimtar këshill nacionalçlirimtar Balli Kombëtar Konferenca e Mukjes	Libri i nxënësit, hartë e Shqipërisë, interneti, enciklopedi etj	- Gjuhën - Letërsinë - Gjeografinë	Diskutim/ INSERT/ Lexim dhe mendim i drejtuar.

Organizimi i orës së mësimi

Mësuesi, për të nxitur kureshtjen e nxënësve, shfaq në monitor sekuenca mbi pushtimin fashist italian të Shqipërisë.

Shih: <https://www.youtube.com/watch?v=RTk0tunwtYs>

Organizohet në klasë diskutimi lidhur me faktet që nxënësit njohin rreth pushtimit fashist të Shqipërisë dhe tipareve të tij.

Mësuesja udhëzon nxënësit të lexohet mësimi duke i kërkuar të vendosin përbri secilës pjesë të lexuar shenjat të cilat kanë kuptimin e mëposhtëm:

“√” vendoset përbri informacionit që për ju është i njohur;

“-” vendoset përbri informacionit që ju e dinit ndryshe;

“+” vendoset përbri informacionit i cili është i ri për ju;

“?” vendoset përbri informacionit i cili është i paqartë ose doni të dini më shumë.

Pas leximit organizohet në klasë bashkëbisedim ku nxënësit krahasojnë shenjat e vendosura dhe diskutojnë rreth fakteve të reja.

✓	-	+	?
- Italia fashiste kishte një ndikim të madh në Shqipërinë e viteve '20 – '30. - Mbreti Zog nuk mundi ta mbante nën kontroll këtë ndikim. - Populli shqiptar përkrahte qëndresën ndaj pushtimit fashist. - Rezistenca ndaj pushtimit nuk ishte e organizuar siç duhej.	-Nxënësit mund të kenë informacion të ndryshëm lidhur me organizimin e rezistencës ndaj pushtimit fashist. -nxënësit mund të dinë dhe informacione të tjera të cilat shënohen nga mësuesi në kolonën përkatëse të tabelës.	- Italia fashiste i drejtoi disa ultimatumet mbretit Zog përpara se të niste sulmin. Këto ultimatumet përmbanin kërkesa thuajse të pamundura për t'u plotësuar nga ana e tij. - bashkimi i Shqipërisë me Italinë u bë në formën e një “bashkimi personal”, nën	- Informacion shtesë lidhur me kuptimin dhe thelbin real të krijimit të “Shqipërisë së Madhe” nën influencën italiane. (Mësuesi mund të përzgjedhë informacione të ndryshme)

- Shqipëria nuk mori përkrahje ndërkombëtare kundër pushtimit fashist. - Pas pushtimit, Shqipëria e humbi pavarësinë dhe u kthye në një provincë italiane. - Përfaqësuesit italianë kontrollonin të gjitha levat e pushtetit në Shqipërinë e pushtuar. - Italianët synuan fashistizimin e gjithë jetës së vendit. - Që në fillime, pushtimi u kundërshtua nga populli shqiptar në forma të ndryshme. (nxënësit mund të kenë dhe informacione të tjera të njohura).		kurorën mbretërore të Viktor Emanuelit III. - për shkakun e mësipërm, kur Italia fashiste sulmoi Greqinë edhe Shqipëria “i shpalli” luftë kësaj të fundit. Shqiptarët e përfshirë në forcat e armatosura italiane dezertuan në masë.	
--	--	---	--

2. Shfaqen për nxënësit pamjet filmike lidhur me Konferencën e Mukjes.

Shih: <https://www.youtube.com/watch?v=f5wkXeimzag>

Mësuesi nxit kureshtjen e nxënësve duke drejtuar pyetje dhe organizuar diskutimin në klasë.

- Cilat ishin forcat apo organizatat kryesore politike antifashiste në Shqipëri?

- Çfarë kishin të përbashkëta dhe të veçanta këto forca politike?

✓	-	+	?
- Italia fashiste kishte një ndikim të madh në Shqipërinë e viteve '20 – '30. - Mbreti Zog nuk mundi ta mbante nën kontroll këtë ndikim. - Populli shqiptar përkrahte qëndresën ndaj pushtimit fashist. - Rezistenca ndaj pushtimit nuk ishte e organizuar siç duhej. - Shqipëria nuk mori përkrahje ndërkombëtare kundër pushtimit fashist. - Pas pushtimit, Shqipëria e humbi pavarësinë dhe u kthye në një provincë italiane.	- Nxënësit mund të kenë informacion të ndryshëm lidhur me organizimin e rezistencës ndaj pushtimit fashist. - nxënësit mund të dinë dhe informacione të tjera të cilat shënohen nga mësuesja në kolonën përkatëse të tabelës.	- Italia fashiste i drejtoi disa ultimatumë mbretit Zog përpara se të niste sulmin. Këto ultimatumë përmbanin kërkesa thuajse të pamundura për t'u plotësuar nga ana e tij. - bashkimi i Shqipërisë me Italinë u bë në formën e një “bashkimi personal”, nën kurorën mbretërore të Viktor Emanuelit III. - për shkakun e mësipërm, kur Italia fashiste sulmoi Greqinë, edhe Shqipëria “i shpalli” luftë kësaj të fundit. Shqiptarët e përfshirë në forcat e armatosura italiane dezertuan në masë.	- Informacion shtesë lidhur me kuptimin dhe thelbin real të krijimit të “Shqipërisë së Madhe” nën influencën italiane. (Mësuesi mund të përzgjedhë informacione të ndryshme)

- Përfaqësuesit italianë kontrollonin të gjitha levat e pushtetit në Shqipërinë e pushtuar. - Italianët synuan fashistizimin e gjithë jetës së vendit. - Që në fillim, pushtimi u kundërshtua nga populli shqiptar në forma të ndryshme. (nxënësit mund të kenë dhe informacione të tjera të njohura).			
--	--	--	--

- A ekzistonte bashkëpunim apo kundërvënie mes forcave të ndryshme antifashiste në Shqipëri deri në shtator 1943?
- Cila mendoni se ishte forca më e organizuar politikisht dhe ushtarakisht?
- Vini në dukje përpjekjet për krijimin e një fronti të përbashkët antifashist.
- Përse dështuan këto përpjekje?

Metodologjia: diskutim/ insert/ lexim dhe mendim i drejtuar.

Organizimi i orës së mësimit:

1. mësuesi, për të nxitur kureshtjen e nxënësve, shfaq në monitor sekuenca mbi pushtimin fashist italian të shqipërisë.

shih: <https://www.youtube.com/watch?v=f5wkxeimzag>

organizohet në klasë diskutimi lidhur me faktet që nxënësit njohin rreth pushtimit fashist të Shqipërisë dhe tipareve të tij.

mësuesi udhëzon nxënësit të lexohet mësimi duke u kërkuar të vendosin përbri secilës pjese të lexuar shenjat të cilat kanë kuptimin e mëposhtëm:

Ndërtimi i njohurive:

- “ ✓ ” vendoset përbri informacionit që për ju është i njohur;
- “ - ” vendoset përbri informacionit që ju e dinit ndryshe;
- “ + ” vendoset përbri informacionit i cili është i ri për ju;
- “ ? ” vendoset përbri informacionit i cili është i paqartë ose doni të dini më shumë.

2. pas leximit organizohet në klasë bashkëbisedim ku nxënësit krahasojnë shenjat e vendosura dhe diskutojnë rreth fakteve të reja.

3. shfaqen për nxënësit pamjet filmike lidhur me konferencën e Mukjes.


shih: <https://www.youtube.com/watch?v=f5wkxeimzag>

mësuesi nxit kureshtjen e nxënësve duke drejtuar pyetje dhe organizuar diskutimin në klasë.

- cilat ishin forcat apo organizatat kryesore politike antifashiste në Shqipëri?
- çfarë kishin të përbashkëta dhe të veçanta këto forca politike?
- a ekzistonte bashkëpunim apo kundërvënje mes forcave të ndryshme antifashiste në shqipëri deri në shtator 1943?
- cila mendoni se ishte forca më e organizuar politikisht dhe ushtarakisht?
- vini në dukje përpjekjet për krijimin e një fronti të përbashkët antifashist.
- përse dështuan këto përpjekje?

Ndërtimi i njohurive:

- mësuesi orienton nxënësit të lexojnë pjesën e parë të mësimi dhe shkruan në tabelë pyetjet që nxënësit duhet t'u përgjigjen pas leximit.
- pyetjet:
 - cilat ishin format e shprehjes së ndjenjave antifashiste të popullsisë në fillimet e pushtimit fashist? me çfarë vështirësish u përball mbreti zog për të dalë në krye të rezistencës së organizuar të shqiptarëve?
 - cilat ishin rrymat e tjera politike antifashiste dhe cilat ishin përpjekjet e tyre për organizim? përgjigjet e nxënësve mund të shënohen në mënyrë skematike në tabelë.




mësuesi orienton nxënësit të lexojnë pjesën e dytë të mësimit dhe shkruan në tabelë pyetjet që nxënësit duhet t'u përgjigjen pas leximit.

pyetjet:

- Evidentoni procesin e organizimit të forcave politike antifashiste në Shqipëri.
- A paraqiste programi i PKSH-së elemente të doktrinës marksiste? si u munduan komunistët shqiptarë që të paraqisnin një qasje sa më gjithëpërfshirëse në luftën e armatosur antifashiste?
- Cili ishte programi i “ballit kombëtar” dhe ku mbështetej ai?

Përgjigjet e nxënësve mund të shënohen në mënyrë skematike në tabelë.



po kështu vazhdohet dhe me pjesën tjetër të mësimit .

- **shënim:** këto veprimtari mund të zhvillohen përgjatë 40-45 minuta, në varësi të planifikimit dhe ndarjes së orës 90 minutëshe mes kontrollit të njohurive dhe dhënies së njohurive të reja.

Pyetje për diskutim.

situata quhet e realizuar nëse nxënësi:

- shpjegon rrethanat e krijuara në prag të sulmit italian mbi Shqipërinë dhe pozicionin e mbretit zog dhe qeverisë së tij në raport me pushtimin fashist;
- përshkruan zhvillimin e invazionit italian dhe organizimin e rezistencës ndaj tij;
- tregon ndryshimet institucionale dhe kushtetuese që solli pushtimi italian mbi shtetin shqiptar;
- shpjegon rrugët e përdorura prej pushtuesit për të shtrirë parimet dhe politikat fashiste në çdo fushë të jetës në Shqipëri;
- përshkruan frymën e rezistencës antifashiste në gjirin e popullit shqiptar, disa prej formave dhe ngjarjeve fillestare të kësaj rezistence dhe zgjerimin e luftës antifashiste në Shqipëri;
- shpjegon proceset e krijimit të forcave të ndryshme antifashiste dhe programet e veprimit e tyre konkrete;
- analizon vendimet e konferencës së Mukjes dhe faktorët që ndikuan në hedhjen poshtë të tyre nga partia komuniste shqiptare.

Vlerësimi:

Vlerësimi i nxënësit mbështetet në kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime dhe nivelin e arritjeve.

Niveli 2:

- përshkruan zhvillimin e pushtimit fashist italian të Shqipërisë në prill 1939;
- përshkruan format kryesore të rezistencës antifashiste në Shqipëri para dhe përgjatë pushtimit italian;
- identifikon disa prej figurave kryesore të fillimeve të rezistencës shqiptare;
- liston organizatat kryesore politike në Shqipëri në periudhën e pushtimit fashist;

Niveli 3:

- shpjegon proceset e krijimit të formacioneve kryesore politike të rezistencës shqiptare;
- evidenton zhvillimin e rezistencës antifashiste deri në luftë të armatosur;

- analizon programet e forcave kryesore antifashiste shqiptare;
- vlerëson pozitat e këtyre forcave në prag të ardhjes së gjermanëve në Shqipëri;

Niveli 4:

- krahason programet e organizatave më të rëndësishme të rezistencës duke vënë në dukje dallimet mes tyre.
- analizon arsyet e mbledhjes së Mukjes dhe rolin e pozicionet e frontit antifashist dhe balli kombëtar në këtë konferencë;
- gjykon mbi shkaqet e prishjes së marrëveshjes së Mukjes dhe përgjegjësitë në lidhje me këtë akt;

Detyrat dhe puna e pavarur (alternativisht):

- Zhvilloni hulumtime paraprake për të dhënat që vijnë nga burime të ndryshme lidhur me aspekte të jetës së rinisë nën regjimin fashist italian.
- Mblidhni fakte rreth pikëpamjeve të ndryshme për rëndësinë e Konferencës së Mukjes dhe ndikimin e mosnjohjes së vendimeve të saj në ecurinë e mëtejshme të situatës në Shqipëri.

MODEL ORE MËSIMORE NË LËNDËN E HISTORISË NË AML

Shkalla: IV	Lënda: Histori	Shkalla: 5	Klasa: 10
Tema mësimore: Revolucioni Amerikan. Kushtetuta (45 minuta)		Situata e të nxënës: SHBA çdo 4 korrik feston Ditën Kombëtare të Shteteve të Bashkuara me fishekzjarrë, parada karnavale, panairë, piknik, festim familjar. Përgjigjuni pyetjeve: - Si mendoni me cilën ngjarje lidhet kjo ditë? - Çfarë ju kujton T. Xheferson? - Po Abraham Linkoln?	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përcakton shkaqet e luftës për pavarësi të kolonive Angleze të Amerikës së Veriut. 2. Analizon shkaqet e luftës civile dhe rrjedhojat e saj 3. Vlerëson rëndësinë e Deklaratës së Pavarësisë dhe rolin e Kushtetutës amerikane në qytetërimin botëror.			

Lidhja me fushat e tjera të të nxënësve: - Gjuha dhe komunikimi, TIK-u, Gjeografia, Qytetaria Lidhja me temat ndërkurikulare: - Respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut, Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	Burimet: Histori 10, Interneti. Wikipedia sq.m.wikipedia.org Mjetet: Foto e figurave të Revolucionit Amerikan Deklaratës së Pavarësisë, harta e Amerikës, video projektor.	Fjalët kyç: Deklarata e Pavarësisë, abolicionistë, luftë civile, merkantilizëm, konfederatë, koloni, bojkot, lëvizje federaliste, fuqi supreme, forca unioniste, ndarje pushtetesh.
--	---	---

Organizimi i orës së mësimi:

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve janë përzgjedhur duke konsideruar dhe stilet e të nxënësve: dëgjimor; kinestetik; pamor; lexim-shkrimi.

Fazat	Strategjitë	Veprimtaritë e nxënësve	Organizimi i nxënësve
P	Stuhi mendimesh	Nxitja e diskutimit	Punë me gjithë klasën
N	Harta e konceptit	Ndërtimi i kompetencave historike dhe kyçe	Punë në grupe
P	Diagrami i Venit	Paraqitja grafike	Punë në dyshe

Parashikimi

Mësuesi/ja nëpërmjet pyetjeve më poshtë sjell në vëmendje të nxënësve njohuritë e mëparshme nëpërmjet lidhjes me revolucionin Anglez.

Mësuesi/ja pyet:

- Si u kufizua pushteti i mbretit në Angli?
- Cili ishte ndryshimi midis revolucionit dhe revolucionit të lavdishëm?
- Çfarë qeverisje pati Anglia pas revolucionit?
- Cili qe karakteri i Aktit të të Drejtave të Njeriut?

Nxënësit shprehin mendimet e tyre për pyetjet e mësipërme.

Brainstorming:

Nxënësit shikojnë një dokumentar në lidhje me shpalljen e Pavarësisë së SHBA

<https://youtu.be/cdVJij8WdPg>, pasi shikohet dokumentari diskutohet situata e të nxënësve dhe nxënësve tu përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:

- Si mendoni me cilën ngjarje lidhet kjo ditë?
- Çfarë ju kujton T. Xheferson?
- Po Abraham Linkoln?
- Nxirrni një fakt dhe një opinion nga video që patë.

Veprimtari: Ndërtimi i fjalorit. Përcaktoni termat e mëposhtëm bazuar në të kuptuarit e kontekstit historik. Nxënësit plotësojnë tabelën më poshtë në çift duke konsideruar dhe stilet e të nxënësve: dëgjimor; kinestetik; pamor; lexim-shkrim.

Terma	Përkufizimi
– Luftë Civile – Shtete të Unionit – Konfederatë – Abolicionistë – Koloni	

Ndërtimi i njohurive

Realizohet njohja e nxënësve me kompetencat e orës

Më pas nxënësit sistemojnë njohuritë:



Veprimtaria: Mësuesi/ja i ndan nxënësit në grupe (teknika me numerim 1,2,3,4,5) duke i udhëzuar ata të lexojnë çështjet mësimore.

Grupi 1: Shkaqet e luftës për pavarësi

1. Koloni britanike
2. Nuk përfaqësoheshin në parlament
3. Vareshin nga sistemi tregtar britanik
4. Rritja e taksave për shkak të luftës 7-vjeçare me Francën

Grupi 2: Zhvillimi i luftës:

Masaçustesi qendra e luftës antibritanike

Filadelfia: Kongresi i parë Kontinental vendosi:

zhvillimin e protestave, krijimin e komisioneve për bojkot dhe mbledhjen e Kongresit të dytë.

Kongresi 2 maj 1775 udhëzoi T. Xheferson të hartonte Deklaratën e Pavarësisë 4 korrik 1776 shkëputja nga BM


Grupi 3: Kushtetuta:

1787 Konventa miratoi Kushtetutën:

SHBA shtet federal

ndarja e pushteteve: legjislativ (kongresi) ekzekutiv (presidenti) gjyqësor (gjykatat federale)

Grupi 4: Lufta civile:



Grupi 5:

Shkaqet e luftës civile. Duke pasur parasysh arsyet pas shpërthimit të Luftës Civile, zgjidhni dy prej shkaqeve që ju i konsideroni si çështja më urgjente që shkaktoi këtë ngjarje. Citoni fakte historike për të mbështetur përgjigjen tuaj.

1

2

Nxënësit sipas grupeve pasqyrojnë momentet kyçe që ata kanë nxjerrë nga leximi. Më pas kalohet në diskutimin e këtyre çështjeve.

Ndërtimi i shprehive studimore.

Në përfundim mësuesi/ja u kërkon nxënësve që të vazhdojnë punën me plotësimin e Diagramin e Venit

Veprimtari: Diagrami i Venit

Nxënësit nxjerrin të përbashkëtat e të veçantat e Revolucionit Anglez dhe Amerikan

Revolucionit Anglez	Të përbashkëtat	Revolucionit Amerikan
1.		1.
2.		2.
3.		3.
4.		4.

Pyetje

Pas plotësimit të tabelës mësuesi/ja drejton pyetjet:

- Ku qëndron rëndësia e miratimit të Deklaratës së Pavarësisë?
- Pse themi që SHBA merret si shembulli i demokracisë në botë?
- Cilat qenë efektet e Luftës Civile?

Vlerësimi (vlerësohen nxënësit për kërkimin historik, përdorimin e burimeve, analizën shkak-pasojë, interpretimin dhe prezantimin bazuar në argumentet që japin, kontributin në punën në grup dhe punën me hartën, përdorimin e TIK))

Vlerësohet në nivelin N2:

Nxënësi që përcakton shkaqet e luftës për Pavarësi dhe vendimet e Kongresit I Kontinental

Vlerësohet në nivelin N3:

Nxënësi që analizon shkaqet, zhvillimin e pasojat e Luftës Civile?

Vlerësohet në nivelin N4:

Nxënësi që vlerëson përmbajtjen e Deklaratës së Pavarësisë, Kushtetutës Amerikane dhe rolin e tyre në demokracinë botërore

Detyra dhe puna e pavarur. Linja e kohës

Nxënësi përcakton në linjën e kohës ngjarjet më të rëndësishme historike që çuan në shpërthimin e luftës civile deri në përfundim të saj.



VIII. VLERËSIMI I NXËNËSVE NË LËNDËN E HISTORISË

Qëllimi i vlerësimit: Qëllimi kryesor i vlerësimit është **përmirësimi i përmbushjes së rezultateve të të nxënësve** nga nxënësi dhe i vetë procesit të të nxënësve. Vlerësimi është procesi gjatë të cilit **mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën** e arritjes së rezultateve të të nxënësve bazuar në nivelet e arritjes. Vlerësimi është një pjesë e rëndësishme e procesit të mësimdhënie - nxënies.

Vlerësimi përdoret për:

- ☞ të gjykuar mbi përpjekjet e nxënësve;
- ☞ të matur arritjet e nxënësve;

- ✎ të gjykuar dhe përmirësuar procesin e mësimdhënie -nxënie;
- ✎ të raportuar arritjet;
- ✎ t'u dhënë sugjerime nxënësve për përparimin e tyre.

Vlerësimi në histori mat arritjet e nxënësve për rezultatet e të nxënit të përshkruara në programin mësimor. Është një proces i vazhdueshëm i identifikimit, mbledhjes dhe interpretimit të informacionit në lidhje me arritjet e nxënësit dhe mund të integrohet në të nxënit normal të nxënësve.

Vlerësimi i nxënësit kryhet nëpërmjet:

- a) vlerësimi të vazhduar;
- b) vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse;
- c) vlerësimi me projekt kurrikular.

8.1. Vlerësimi i vazhduar (për të nxënë)

- Vlerësimi i vazhduar për të nxënë është pjesë e mësimdhënies dhe motivon përparimin e nxënësit në të gjitha aspektet e të nxënit, në situata të ndryshme të njohura dhe të panjohura.
- Vlerësimi i vazhduar bazohet në vëzhgimet dhe në gjykimet e mësuesit mbi përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, diskutimet, vetëvlerësimin e nxënësit, vlerësimin e nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjen në aktivitete dhe në debatet në klasë, vlerësimin e detyrave të shtëpisë apo të klasës etj.
- Mësuesi vlerëson nxënësin me notë në regjistër, vetëm pasi është siguruar që ky vlerësim është objektiv dhe shpreh shkallën e qëndrueshmërisë së performancës së nxënësit për një periudhë të caktuar kohe. Për këtë qëllim, mësuesi përdor fletoren e tij personale të regjistrimit të përgjigjeve të nxënësit, për të argumentuar në çdo kohë, objektivitetin e vlerësimit të tij me notë në regjistër.
- Fletorja personale e mësuesit nuk është objekt monitorimi.
- Mësuesi shënon në regjistër të paktën 2 (dy) vlerësime me notë për çdo periudhë për lëndët që zhvillohen me 1-2 orë në javë dhe 3 (tri) vlerësime me notë për lëndët që zhvillohen me 3 ose më shumë orë në javë.
- Mësuesi nxjerr notën e vlerësimit të vazhduar për çdo periudhë duke u bazuar në notat e nxënësit në regjistër dhe në shënimet që ka mbajtur në fletoren e tij personale. Mësuesi merr

në konsideratë balancën ndërmjet njohurive, shkathtësive, qëndrimeve, ashtu siç përshkruhet në rezultatet e të nxënit në programin lëndor.

- Mësuesi ka përgjegjësi për të informuar prindërit dhe nxënësin për ecurinë dhe mundësinë e nxënësit për progres.

8.2. Vlerësimi i të nxënit (test/detyrë përmbledhës)

Vlerësimi i të nxënit quhet shpesh vlerësim përmbledhës. Përdoret për të mbledhur prova dhe të dhëna që tregojnë nëse mësimdhënia ka realizuar qëllimin e saj. Zakonisht planifikohet në fund të një njësie apo të një periudhe të caktuar. Ky është një vlerësim **formal** dhe kryhet edhe për efekt raportimi. Në përfundim të periudhës (kur e vendos mësuesi) kryhet **vlerësimi me test/detyrë përmbledhës**, i cili ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni për periudhën përkatëse. Testi/detyra përmbledhëse planifikohet nga mësuesi kur përmbyllet një grup rezultatesh të të nxënit dhe mësuesi është i lirë ta vendosë vetë se kur do ta zhvillojë atë.

Si dhe kur realizohet testi përmbledhës/detyra përmbledhëse?

- Në pjesën e fundit të periudhës kryhet **vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse**, që ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni për periudhën përkatëse. Në lëndët e historisë mësuesi ka liri për përcaktimin e metodës së realizimit të vlerësimit të të nxënit i cili mund të jetë me test ose me detyrë përmbledhëse. Mësuesi përcakton detyrën përmbledhëse në përputhje me veçoritë e lëndës në përmbushje të rezultateve të të nxënit si dhe duke marrë parasysh nivelet e arritjes.
- Testi/detyra përmbledhëse planifikohet nga mësuesi, kur përmbyllet një grup rezultatesh të të nxënit dhe mësuesi është i lirë dhe ka fleksibilitet ta vendosë vetë se kur do ta zhvillojë (jo domosdoshmërisht bëhet në fund të periudhës).
- Testi përmbledhës është 45 minuta.
- Drejtoria e shkollës menaxhon organizimin e testeve/detyrave përmbledhëse sipas një grafiku, në mënyrë që të mos ngarkohet nxënësi në fund të periudhës.
- Testi/detyra përmbledhëse jo domosdoshmërisht bëhet në fund të periudhës. Mësuesi e përcakton vetë kohën se kur do ta zhvillojë atë. (*Shih shembullin te planifikimi i lëndës për një periudhë*).
- Mësuesi duhet të ruajë deri në përfundim të vitit shkollor testet/detyrat përmbledhëse.

- Vlerësimi i testit/detyrës përmbledhëse pasqyrohet në regjistër, në kolonën përkatëse.

8.3. Projekti

Projekti kurrikular është pjesë e vlerësimit të nxënësit.

Projekti si veprimtari integruese me karakter kërkimor e krijues, nxit zhvillimin e aftësive të larta të të menduarit, aftësive komunikuese, të bashkëpunimit, të përdorimit të TIK, të sipërmarrjes etj. Projekti nxit të nxënit dhe mësimdhënies me në qendër nxënësin përmes së cilës nxënësit në mënyrë të pavarur ose/dhe si një anëtar i një grupi hulumtojnë mbi një çështje të caktuar ose një problem të lidhur me jetën reale.

Projekti kurrikular duhet të jetë i shtrirë përgjatë gjithë vitit shkollor, pra në të tri periudhat. Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në mendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit dhe përgjatë zhvillimit të tij.

8.3.1 Vlerësimi me projekt kurrikular

- Mësuesi planifikon dhe organizon një projekt të shtrirë gjatë gjithë vitit shkollor.
- Projekti kurrikular mund të jetë lëndor ose ndërlëndor, mund t'i përkasë një fushe të nxëni ose të shtrihet në më shumë se një fushë të nxëni.
- Drejtoria e shkollës menaxhon kohën e prezantimit dhe të vlerësimit të projektit kurrikular që të shmanget mbingarkesa e nxënësve në fund të vitit shkollor.
- Nota e projektit kurrikular shënohet në regjistër në kolonën përkatëse.
- Projektet e nxënësve ruhen deri në fund të vitit shkollor.

8.3.2 Planifikimi i projektit

Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë efikase i një projekti kërkon që mësuesi të përcaktojë qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënë (është mjaft e rëndësishme që secili nxënës të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara); të paraqesë rezultatet e të nxënit që do të arrihen nëpërmjet projektit; të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit; të qartësojë nxënësit për arritjen përfundimtare të projektit; të qartësojë nxënësit për kriteret e vlerësimit të projektit; të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.

Për realizimin e projektit shfrytëzohen përvojat vetjake të nxënësve dhe njohuritë e marra nga burime të ndryshme. Realizimi i një projekti kërkon përdorimin e më shumë se një metode dhe

teknike, si: vrojtimi, studimi i rastit, intervista, puna në grup, puna individuale, përpunim informacioni statistikor etj.

8.3.3 Stadet kryesore që ndiqen për realizimin e një projekti janë:

- përcaktohet çështja ose problemi për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë;
- përcaktohen detyrat që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e secilit nxënës;
- grumbullohet materiali dhe/ose mjetet e nevojshme;
- përpunohen dhe analizohen të dhënat e grumbulluara;
- nxirren përfundime dhe përgjithësime nga të dhënat e grumbulluara dhe përgatitet produkti përfundimtar;
- Prezantohen gjetjet dhe përfundimet e projektit ose prezantohet produkti i krijuar.

Për planifikimin e një projekti mësuesi ndërton planin e projektit, rubrikat kryesore të të cilit paraqiten më poshtë. Në varësi të tematikës së projektit dhe specifikave të tij, mësuesi mund të pasurojë planin me rubrika të tjera. Mësuesi planifikon në planin e tij ditor çdo orë të planifikuar të projektit sikurse vepron me orët e tjera mësimore.

8.3.4 Rubrikat kryesore të planit të një projekti kurrikular përfshijnë:

- Tema e projektit – Përcaktohet nga mësuesi në bashkëpunim me nxënësi.
- Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore – Mësuesi përcakton orët mësimore për secilën periudhë).
- Rezultatet e të nxënit – Përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që do të zhvillohen përmes veprimtarive të projektit.
- Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit – Përcaktohen konceptet që duhet të zotërojë nxënësi për realizimin e këtij projekti.
- Partnerët - Nëse ka, p.sh., një historian ose një dëshmitar okular.
- Veprimtaritë kryesore – Përcaktohen veprimtaritë që do të realizohen gjatë projektit.
- Burimet kryesore të informacionit – Mësuesi duhet të orientojë nxënësit drejt përdorimit të burimeve të larmishme dhe të duhura të informacionit. Në lëndën e historisë një burim i çmuar informacioni, përveç internetit, hartave dhe teksteve të ndryshme si enciklopeditë, revistat, etj., janë vizitat në muze apo arkiva).

- Tematika e orëve të planifikuara të planit mësimor – Këtu vendoset tematika për çdo orë mësimore të projektit. P.sh, nëse projekti planifikohet në 6 orë atëherë duhet vendosur tematika për të gjashta orët.
- Përshkrimi i produktit të projektit – Duhet të përfshijë shkurtimisht llojin e produktit që pritet të realizohet dhe mënyrën e prezantimit të tij.
- Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi – Mësuesi përcakton kriteret për vlerësimin e projektit të cilat ia komunikon nxënësit që në fillim të projektit. P.sh., kriteret mund të përcaktohen në lidhje me trajtimin e përmbajtjes në përmbushje të tematikës, përdorimin e burimeve të informacionit, interpretimin e informacionit, analizën shkak –pasojë, përgatitjen e produktit, prezantimin e tij etj., në varësi të rezultateve të të nxënës.

Sigurimi i të dhënave nga burime të ndryshme vlerësimi është thelbësore për të nxënësin bazuar në projekte. Përfshirja e nxënësve në vlerësimin e projektit nxit motivimin dhe përmirëson të nxënësit e drejtuar prej tyre. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësve nga njëri-tjetri nxit nxënësit të reflektojnë mbi pikat e tyre të dobëta dhe të forta, në mënyrë që të fokusojnë përpjekjet e tyre të mëtejshme.

Tabela: Instrument i vlerësimit të projektit kurrikular

Kriteret për vlerësimin e projektit nga mësuesi Projekt kurrikular hulumtues Gjithsej 40 pikë				
Kriteret e vlerësimit	Niveli 1 – Dobët 0-10 pikë	Niveli 2 – Mjaftueshëm 11 - 21 pikë	Niveli 3 – Mirë 22- 32 pikë	Niveli 4 – Shumë mirë 33 -40 pikë
Faza e parë 15 pikë Demonstrimi i aftësive hulumtuese	0-4 pikë Nxënësit rrallëherë fokusohen te detyra e tyre. Mbledhin informacione pa gjetur zgjidhje të përshtatshme.	5-8 pikë Nxënësit dalin jashtë temës dhe nuk fokusohen vetëm te detyra e tyre. Mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje me ndihmë.	9-12 pikë Nxënësit janë të fokusuar te detyra e tyre shumicën e kohës. Mbledhin informacion dhe gjejnë	13-15 pikë Nxënësit janë të fokusuar te detyra e tyre. Vetë orientohen dhe vetëdrejtohen shumë mirë. Mbledhin informacion në

	Përdorin një burim për të gjetur informacione.	Përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	zgjidhje standarde. Përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	mënyrë aktive dhe krijojnë komente intuitive për të zgjidhur probleme. Përdorin shumëllojshmëri informacionesh.
Faza e dytë 15 pikë	0 – 4 pikë	5 – 8 pikë	9 – 12 pikë	13 – 15 pikë
Vlerëson burimet historike, analizon dhe interpreton informacionin historik.	Nxënësi rrallëherë vlerëson, analizon burimet historike. Interpretimi historik është i cekët dhe nuk mbështetet në analizë dhe argumente.	Nxënësi ndonjëherë vlerëson, analizon burimet historike duke përzgjedhur ato që janë të besueshme, por jo në mënyrë të vazhdueshme. Interpretimi historik dhe argumentet që e mbështesin këtë interpretim nuk është të plota dhe të sakta.	Nxënësi zakonisht vlerëson, analizon burimet historike duke përzgjedhur ato që janë të sakta dhe të besueshme. Interpretimi historik dhe argumentet që e mbështesin këtë interpretim paraqesin pasaktësi të vogla.	Nxënësit përdorin gjatë gjithë projektit burimet historike të sakta dhe të besueshme. Interpretimi historik dhe argumentet që e mbështesin këtë interpretim janë të plota dhe të sakta.
Faza e tretë 10 pikë	0 – 2 pikë	3 – 5 pikë	6 – 8 pikë	9 – 10 pikë
	Në prezantimin e tyre materiali	Në prezantimin e tyre nxënësit	Në prezantimin e tyre nxënësit	Në prezantimin e tyre nxënësit

Prezanton në mënyrë efektive rezultatet e projektit dhe konceptet kyçe historike.	është i çorganizuar dhe rrëmujë. Është e vështirë të kuptosh cilat informacione shkojnë me njëri-tjetrin. Prezantohen shumë pak rezultate të projektit.	organizojnë mirë punën e tyre, por jo gjithmonë të krijojnë lehtësi dëgjimi dhe të kuptuari. Prezantohen vetëm disa rezultate të projektit.	organizojnë mirë punën e tyre që në shumicën e kohës të krijojnë lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari. Në përgjithësi prezantohen rezultatet e projektit.	organizojnë shumë mirë punën e tyre që të krijojnë lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari. Rezultatet e projektit prezantohen qartë.
---	---	---	--	---

Tabela: Instrument i vetëvlerësimit ose i vlerësimit të nxënësit nga nxënësi

Kritere për vetëvlerësimin e projektit					
Gjithsej 40 pikë					
Kriteret e vlerësimit	Treguesi	ShM	M	Mj	D
Faza e parë 15 pikë Demonstrimi i aftësive hulumtuese	Demonstrim i aftësive hulumtuese				
	Bashkëpunimi në grup. Grupi orientohet dhe drejtohet vetë				
	Përdorimi i shumëllojshmërisë së informacioneve				
	Fokusimi te detyra e dhënë				
	Mbledhja e informacioneve të përshtatshme për detyrën				
Faza e dytë 15 pikë	Përdor gjatë gjithë projektit burimet historike të sakta dhe të besueshme.				
	Analizon saktë konceptet historike.				
	Interpretimi historik dhe argumentet që e mbështesin këtë interpretim janë të plota dhe të sakta.				

Faza e tretë 10 pikë Prezantimi dhe komunikimi në mënyrë efektive i rezultateve të projektit dhe koncepteve kyçe historike.	Organizimi i materialit është i plotë e i saktë dhe të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari.				
	Rezultatet e projektit prezantohen qartë.				
	Kontribuon pozitivisht në progresin e grupit				

8.3.5 Projekti kurrikular vjetor

Qasja kërkimore nëpërmjet punës me projekte

Kërkimi është pjesë përbërëse e programit të historisë dhe një nga kompetencat e kësaj lënde. Duke njohur dhe duke përvetësuar mënyrën se si punojnë historianët, nxënësit zhvillojnë aftësinë për ta zbatuar atë gjerësisht në lëndën e historisë dhe në fusha të tjera. Qasja kërkimore në histori u paraqet nxënësve një mënyrë për të bërë hulumtime, për të organizuar dhe për të shpjeguar ngjarjet që kanë ndodhur. Kërkimi historik është procesi i "të bërit histori". Ai është një proces ciklik që fillon me shtrimin e pyetjeve historike, pasohet nga gjetja dhe analiza e burimeve historike për të krijuar fakte dhe dëshmi historike. Dëshmia historike përdoret më pas për të ndërtuar interpretimet historike që kërkojnë t'iu përgjigjen pyetje historike.

Qasja kërkimore duhet të jetë në qendër të mësimit të historisë dhe mësuesit duhet t'i krijojnë mundësinë nxënësit për të mësuar aftësitë e nevojshme përmes praktikës dhe angazhimit në kërkimin historik. Përdorimi i pyetjeve në çdo njësi mësimore siguron një pikë kontakti për nxënësit për të kërkuar, sistemuar dhe analizuar informacion në përgjigje të çështjeve që hulumtohen në programin mësimor. Qasja kërkimore, kur zbatohet në mënyrë efektive, zhvillon cilësitë historike dhe aftëson nxënësit të jenë të pavarur, krijues dhe mendimtarë kritik. Ajo nxit demonstrimin e kompetencave historike dhe kompetencave kyçe të nxënësit. Tabela e mëposhtme paraqet qëllimin, fazat dhe cilësitë që fiton nxënësi nga përdorimi i kësaj qasjeje në procesin mësimor.

Tabela: Qasja kërkimore

Faza kërkimore	Cilësitë historike	Qëllimi
1. Bën pyetje historike	Kureshtar	Më e rëndësishme për procesin e kërkimit është pikënisja. Mësuesit duhet të udhëhiqen nga treguesit e mëposhtme: • angazhojnë interesin e nxënësve; • identifikojnë pyetjet që do të kërkojnë; (një pyetje e përgjithshme kërkimore e ndjekur nga nën-pyetje); • planifikojnë procesin e kërkimit; • përshkruajnë rezultatin.
2. Identifikon dhe gjen burimet përkatëse	I logjikshëm I balancuar	• Nxënësit vendosin cilat burime janë të dobishme, cilat nuk janë dhe cilat duhen trajtuar me kujdes (me anë të një shembulli mësuesit udhëzojnë paraprakisht nxënësit) • Nxënësit krijojnë fakte dhe dëshmi
3. Analizon lidhjen shkak-pasojë	I logjikshëm I arsyetuar I ditur	• Nxënësit analizojnë lidhjet shkak-pasojë për ndërtimin e ngjarjes duke u bazuar në burimet e gjetura;
4. Ndërton interpretime historike, vlerëson burimet dhe jep argumente	I logjikshëm I balancuar Metodik I arsyetuar I ditur	• Nxënësit mbajnë shënime nga studimi i tyre për burimet. • Nëpërmjet reflektimit dhe diskutimit të drejtuar nga mësuesi, nxënësit janë në gjendje të zhvillojnë përgjigjet për pyetjet hetimore.
5. Kontrollon interpretimet e nxjerra dhe/ose interpretimin e tanishëm historik	I balancuar I arsyetuar I ditur	• Nxënësit tregojnë zgjerimin, thellimin dhe transferimin e dijeve të tyre

6. Shpjegimi dhe komunikimi	I logjikshëm I arsyetuar Metodik I balancuar I ditur	- Nxënësit shpjegojnë dhe prezantojnë përgjigjet e pyetjeve të tyre nëpërmjet mediave të ndryshme (me shkrim; me gojë; TIK); - Nxënësit respektojnë mendimet e shokëve të tyre qofshin ato dhe të ndryshme nga të tyret;
-----------------------------	--	---

8.3.6 Model projekti në lëndën e historisë

Shembull 1

Projekti kurrikular për lëndën e historisë

Projekti mund të strukturohet në 4 ose 5 orë mësimore sipas zgjedhjes së mësuesve dhe nxënësve.

Tema: Shteti shqiptar, sa larg dhe afër Evropës.

Rezultatet e të nxënësve:

Gjatë zhvillimit të këtij projekti, nxënësi:

- evidenton rrethanat historike dhe pozitën e trojeve shqiptare në fillim të shek. XX;
- analizon qëndrimet e Fuqive të Mëdha evropiane ndaj procesit të krijimit të shtetit të pavarur shqiptar dhe hapave të parë të tij;
- vë në dukje përpjekjet e qarqeve patriotike shqiptare për konsolidimin e pozitës së shtetit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris dhe qëndrimin e Fuqive të Mëdha;
- vlerëson politikën e jashtme të monarkisë shqiptare;
- evidenton pozitën e Shqipërisë dhe shtetit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore.
- analizon aleancat dhe rreshtimin ndërkombëtar të shtetit komunist shqiptar pas Luftës së Dytë Botërore;
- përshkruan politikën e izolimit, në marrëdhëniet ndërkombëtare, të Shqipërisë komuniste;
- analizon politikën e hapjes së Shqipërisë pas rrëzimit të sistemit komunist dhe identifikon hapat e Shqipërisë në procesin e integritetit evropian .

Konceptet kryesore: “Bashkim personal”, “Shqipëri e Madhe”, “pavarësi relative”, konjunkturë ndërkombëtare, mbështetje në forcat e veta.

Partnerët: Studiues të historisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Burimet kryesore të informacionit: Teksti mësimor Historia 11, interneti, materiale të shkruara në formë publikimesh apo artikujsh për këtë tematikë, materiale audio vizuale me karakter dokumentar apo artistik, biseda me specialistë të fushës.

Metodologjia që do të përdoret: Punë në grup, hulumtim, intervista, diskutim, analizë, paraqitje, debat dhe shkëmbim mendimesh.

Mjetet në përdorim: Teksti mësimor, materiale të shtypura, informacione nga shtypi i shkruar, kompjuter, video-projektor, smartboard, postera, material vizuale (foto ose filma).

Organizimi i klasës: Nxënësit do të ndahen në grupe duke u orientuar nga periudhat e ndryshme të historisë së marrëdhënieve ndërkombëtare të shtetit shqiptar. Përveç prezantimit të punës hulumtuese sipas tematikës së periudhës, synohet të ndërtohet një vështrim krahasues në kohë i politikës së jashtme dhe marrëdhënieve të shtetit shqiptar me Evropën.

Projekti zhvillohet në fazë duke filluar me përcaktimin e temës dhe duke vazhduar me gjetjen e materialeve, përpunimin e tyre dhe deri në arritjen e një produkti përfundimtar.

Udhëzime për realizimin e projektit:

- Shpjegon rrethanat historike të trojeve dhe popullsisë shqiptare në përfundim të procesit të shpërbërjes së Perandorisë Osmane dhe rreziqet me të cilat përballeshin ato.
- Evidenton rolin e Fuqive të Mëdha evropiane kundrejt shtetit të ri shqiptar dhe diferencon qëndrimet në favor apo kundër duke analizuar përplasjet e interesave mes tyre.
- Arsyeton raportin mes përpjekjeve të faktorit të brendshëm dhe konjunkturave ndërkombëtare të shprehura në Konferencën e Paqes në Paris në konsolidimin e pozitave dhe njohjes ndërkombëtare të Shqipërisë.
- Analizon konceptet “bashkim personal”, “Shqipëri e Madhe”, “pavarësi relative”, në kuadër të pozitës së shtetit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore.
- Hulumtohet mbi ndryshimet në politikën e jashtme të shtetit shqiptar, orientimin e tij në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe ndryshimet në sistemet e aleancave pas ardhjes në pushtet të Partisë Komuniste.
- Debatohet mbi tiparet, ngjarjet kryesore dhe politikat përcaktuese të pozicionit të Shqipërisë në raport me marrëdhëniet ndërkombëtare drejt një izolimi progresiv deri në zbatimin e politikës “Te mbështetemi në forcat tona”.

Përshkrimi përmbledhës i veprimtarive kryesore që do të zhvillohen gjatë projektit:

Nxënësit:

- ndahen në grupe, sipas vlerësimit të mësuesit, me qëllim realizimin e projektit, njihen me përmbajtjen e projektit dhe burimet e informacionit dhe me metodën e punës dhe japin idetë e tyre;
- marrin nga mësuesi sugjerime mbi shpërndarjen e punës brenda grupit dhe ndajnë detyra brenda grupit;
- në vazhdim të punës evidentohet kontributi i secilit anëtar të grupit dhe shkalla e bashkëpunimit midis tyre;
- raportohen vështirësitë dhe bëhen sugjerime edhe nga nxënës të grupeve të tjera mbi zgjidhje dhe ide të ndryshme;
- nxënësit raportojnë punën e bërë deri në faza të ndryshme të projektit në trajtën e një raporti paraprak, ndaj u këshillohet të tregojnë një vëmendje të veçantë për origjinalitetin e punimit;
- evidentohet kontributi i secilit anëtar të grupit dhe shkalla e bashkëpunimit midis tyre;
- nxënësit përshkruajnë shkallën e përdorimit të burimeve të informacionit, rrugët e sigurimit dhe vlefshmëria e tyre;
- raportohen vështirësitë dhe bëhen sugjerime edhe nga nxënës të grupeve të tjera mbi zgjidhje dhe ide të ndryshme;
- në përfundim të projektit, bëhet paraqitja e punës së secilit grup, që mund të bëhet në mënyrë elektronike ose me anë të posterave, skemave etj., sipas vendimmarrjes së grupit;
- dorëzohet produkti i shtypur dhe CD shoqëruese;
- diskutohen dhe debatohen në klasë lidhur me përfundimet e arritura;
- nxënësit vlerësojnë argumentet e njeri – tjetrit; mësuesi vlerëson punën e secilit grup me argumentet më bindëse dhe mënyrën sesi e kanë paraqitur projektin.

Tematika e orëve të planifikuara të planit mësimor:

Ora I: Diskutimi i temës së projektit dhe përcaktimi i tematikave të veçanta dhe krijimi i grupeve të punës

Ora 2: Bisedë me studiues të historisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare/ Hulumtim mbi dokumentet historike dhe në internet

Ora 3: Përgatitja e informacionit për prezantim

Ora 4-5:Prezantimi i projektit

Përshkrimi i produktit të projektit (duhet të përfshijë shkurtimisht llojin e produktit që pritet të realizohet dhe mënyrën e prezantimit të tij).

- Nëpërmjet këtij projekti nxënësit do të demonstrojnë njohuri/ shprehje/aftësi e qëndrime për zhvillimin e pozitës ndërkombëtare të Shqipërisë që nga themelimi i shtetit të pavarur shqiptar e deri në ditët tona. Ai duhet të diferencojë fazat e ndryshme të zhvillimit të kësaj pozite me veçoritë dhe të përbashkëtat e tyre. Një theks i veçantë do t'u vihet raporteve të Shqipërisë me vendet evropiane dhe vendin e saj në këto raporte deri në aspiratën e sotme për integrim në Bashkimin Evropian.
- Prezantimi i projektit do të realizohet në formën e dokumentarit, materialit në powerpoint/ albumit ose posterit. Pra, grupet do të përzgjedhin një nga format e prezantimit.

SKEMA E VLERESIMIT

Projekti kurrikular vjetor				
Periudha	Kriteri	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
Periudha 1	Strukturën pyetësorët/intervistat në përmbushje të tematikës dhe mbledhjes së të dhënave.	Formulon pyetje të cilat nuk e adresojnë problemin konkret dhe grumbullimin e të dhënave. (2 pikë)	Formulon pyetje që adresojnë pjesërisht problemin dhe mundësojnë grumbullimin e të dhënave. (3 pikë)	Formulon pyetje që adresojnë tërësisht problemin dhe mundësojnë grumbullimin e të dhënave. (5 pikë)
	Identifikon dhe përdor burime të larmishme për hulumtimin e informacionit.	Përdor burime të ndryshme për hulumtimin e informacionit. (2 pikë)	Identifikon dhe përdor burime të ndryshme për hulumtimin e informacionit pa vlerësuar vlefshmërinë dhe	Identifikon dhe përdor burime të ndryshme për hulumtimin e informacionit duke vlerësuar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre.

			besueshmërinë e tyre. (4 pikë)	(6 pikë)
	Shkëmben ide dhe bashkëpunon në grup.	I bashkohet grupit, por nuk është aktiv në realizimin e detyrës. (1 pikë)	Bashkëpunon me grupin vetëm kur i kërkohet nga anëtarët e tjerë. (2 pikë)	Demonstron gatishmëri për realizimin e detyrës dhe ndan ide me të tjerët. (3 pikë)
Totali		15 pikë		
Periudha 2	Përpunon informacionin e mbledhur bazuar në të dhëna.	Identifikon informacionin dhe të dhënat historike për të nxjerrë përfundime të thjeshta. (1 pikë)	Përshkruan informacionin dhe të dhënat historike për të nxjerrë përfundime bazuar në të dhëna. (2 pikë)	Analizon dhe interpreton informacionin dhe të dhënat historike për të nxjerrë përfundime dhe evidentuar kufizimet. (2 pikë)
	Organizon draft-produktin në përmbushje të tematikës dhe zgjidhjes së problemit.	Strukturon raportin në çështje që adresojnë pjesërisht problemin, por nuk ofrojnë zgjidhje. (1 pikë)	Strukturon raportin në çështje që adresojnë pjesërisht problemin dhe ofrojnë zgjidhje të pjesshme. (2 pikë)	Strukturon raportin në çështje që adresojnë tërësisht problemin dhe ofrojnë zgjidhje. (3 pikë)

	Shkëmben ide dhe bashkëpunon në grup. (2 pikë)	I bashkohet grupit, por nuk është aktiv në realizimin e detyrës. (1 pikë)	Bashkëpunon me grupin vetëm kur i kërkohet nga anëtarët e tjerë. (1 pikë)	Demonstron gatishmëri për realizimin e detyrës dhe ndan ide me të tjerët. (2 pikë)
Totali		15 pikë		
Periudha 3	Trajton tematikën në funksion të zgjidhjes së problemit.	Identifikon zgjidhje për çështjen historike aktuale pa u thelluar në pasojat e mundshme të zgjidhjes së propozuar. (1 pikë)	Propozon zgjidhje për çështjen historike aktuale dhe identifikon disa ndër pasojat e mundshme të zgjidhjes së propozuar. (2 pikë)	Propozon zgjidhje për çështjen historike aktuale dhe analizon pasojat e mundshme të zgjidhjes së propozuar. (3 pikë)
	Prezanton informacionin duke përdorur kronologjinë, gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm historik	Organizon me vështirësi informacionin, pa e përshtatur për audiencën e synuar. (2 pikë)	Organizon informacionin, pa e përshtatur atë për audiencën e synuar dhe e përcjell qartë; përdor kronologjinë, fjalorin dhe	Organizon informacionin, e përshtat atë për audiencën e synuar dhe e përcjell qartë; përdor kronologjinë, fjalorin dhe terminologjinë historike. (3 pikë)

			terminologjinë historike. (3 pikë)	
	Shkëmben ide dhe bashkëpunon në grup për prezantimin e produktit përfundimtar	I bashkohet grupit, por nuk është aktiv në realizimin e detyrës. (1 pikë)	Bashkëpunon me grupin vetëm kur i kërkohet nga anëtarët e tjerë. (2 pikë)	Demonstron gatishmëri për realizimin e detyrës dhe ndan ide me të tjerët. (3 pikë)
Totali		20 pikë		

8.4 Vlerësimi i të nxënit të nxënësit realizohet nëpërmjet:

- vlerësimit periodik;*
- vlerësimit përfundimtar.*

8.4.1 Vlerësimi periodik

- Vlerësimi periodik është dokumentimi në regjistër i rezultateve të vlerësimit të nxënësve për secilën periudhë. Ai përmban 2 (dy) nota:
 - notën e vlerësimit të vazhduar;*
 - notën e vlerësimit me test ose me detyrë përmbledhëse.*
- Këto dy vlerësime me notë shënohen në regjistër në kolonat përkatëse.

8.4.2 Vlerësimi përfundimtar

- Vlerësimi përfundimtar realizohet me notë, në përfundim të vitit shkollor.
- Nota përfundimtare vjetore përmbledh notat vjetore si më poshtë:
 - notën vjetore të vlerësimit të vazhduar për tri periudha;
 - notën vjetore të vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse për tri periudha;
 - notën e vlerësimit të projektit.

3. Peshat në përqindje sipas vlerësimeve janë:

	Pesha në përqindje klasat X-XII
Vlerësimi i vazhduar	40%
Vlerësimi me test/detyrë përmblledhëse	40%
Vlerësimi i projektit kurrikular	20%

4. Hapat për njehsimin e notës përfundimtare vjetore janë:

- nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NVv) përcaktohet duke u bazuar në tri notat e vlerësimit të vazhduar të periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive;
- nota vjetore e vlerësimit me test/detyrë përmblledhëse (NTp/Dp) përcaktohet duke u bazuar në tri notat e vlerësimit me test/detyrë përmblledhëse të periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive;
- nota e vlerësimit të projektit (NVp) përcaktohet në përfundim të projektit duke u bazuar në procesin e realizimit të projektit dhe në produktin përfundimtar;
- shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse. Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (p.sh., 8,8 $\approx$ 9);
- Formulat për llogaritjen e notës përfundimtare janë:
 - *Nota përfundimtare në klasat X-XII* = $(NVv \times 0.4) + (NTp/Dp \times 0.4) + (NVp \times 0.2)$
- dokumentimi në regjistër i rezultateve të vlerësimit të të nxënës sipas periudhave është si në tabelën më poshtë:

Shembull

Periudha e parë shtator – dhjetor		Periudha e dytë janar - mars		Periudha e tretë prill - qershor		Vlerësimi vjetor			Nota përfundimtare
NVv	NTp/Dp	NVv	NTp/Dp	NVv	NTp/Dp	NVv	NTp/Dp	NVp	
6	6	8	7	8	7	8	7	9	8

$$(8 \times 0.4) + (7 \times 0.4) + (9 \times 0.2) = 7.8$$

Nota përfundimtare 8

8.5 Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta

Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta duhet të bëhet në mënyrë të tillë që t'u japë atyre mundësinë të demonstrojnë çfarë dinë dhe mund të bëjnë në përmbushje të rezultateve të të nxënit. Për këtë qëllim mësuesi duhet të përshtatë detyrat/veprimtaritë vlerësuese me mundësitë dhe nevojat që këta nxënës kanë. Këto modifikime mund të përfshijnë:

- ndryshimin/përshtatjen e formateve alternative të pyetje/përgjigjeve, p.sh. një formë të përgjigjes më të thjeshtuar (bazuar në disa pika orientuese) në vend të një eseje që duhet të përgatisin nxënësit;
- modifikime të veprimtarive vlerësuese, p.sh. duke thjeshtuar gjuhën e përdorur, ose duke përdorur një format tjetër të pyeturi;
- përshtatje të procesit të vlerësimit, p.sh. duke i dhënë kohë shtesë nxënësit, me pauza të ndërmjetme, duke përdorur një lexues ose teknologji specifike.

Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herëpashere me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

8.6 Nivelet e arritjeve

Arritjet e nxënësve regjistrohen dhe raportohen kundrejt niveleve të arritjes. Mësuesi duhet të përdorë nivelet e arritjes kur merr një vendim për arritjet e nxënësve në lidhje me rezultatet e të nxënit. Nivelet e arritjes përshkruajnë nivelin në të cilën nxënësi duhet të punojë për të arritur një nivel ose notë të caktuar. Nxënësit gjithmonë duhet të kenë një kopje të niveleve të arritjes në mënyrë që ata të dinë se çfarë duhet të bëjnë dhe të jenë në gjendje të bëjnë për të arritur në një nivel apo për të marrë një notë të mirë në një detyrë. Nivelet e arritjes ju ndihmojnë në shënimet tuaja për të orientuar nxënësit të përmirësojnë performancën e tyre në të ardhmen. Për të siguruar interpretim korrekt të niveleve të arritjeve kur mësuesi vlerëson nxënësit, duhet që të gjithë nxënësit të përfundojnë të njëjtën detyrë në të njëjtat kushte dhe të gjithë mësuesit të përdorin të njëjtat nivele arritjesh për vendosjen e notës.

Mësuesit pastaj mund të krahasojnë punën e nxënësve dhe të vijnë në një të kuptuar të përbashkët të niveleve të arritjeve. *(Shih zbërthimin e niveleve të arritjeve te modeli i planifikimit ditor, projekti, apo te modeli i testit).*

8.7 Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësit nga nxënësi

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësit nga nxënësi i ndihmon ata të kuptojnë më shumë se si të mësojnë. Nxënësit vlerësojnë punën e tyre (vetëvlerësimin) ose punën e të tjerëve (vlerësimi i nxënësit nga nxënësi). Nxënësve duhet t'u ofrohet mundësia për të vlerësuar të nxënësit e tyre dhe të nxënësit e të tjerëve sipas kriterëve të përcaktuara.

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësit nga nxënësi:

- vazhdon ciklin e të mësuarit duke bërë pjesë vlerësimin e të nxënësit;
- u tregon nxënësve pikat e forta dhe ku ata duhet të përmirësohen;
- angazhon nxënësit në mënyrë aktive në procesin e vlerësimit;
- u mundëson nxënësve që të jenë përgjegjës për mësimin;
- ndihmon nxënësit të kuptojnë kriteret e vlerësimit dhe nivelet e arritjes.

Vlerësoni në klasë - përdorni kohën e klasës për të kryer dhe për të vlerësuar detyrat e klasës, detyrat e shtëpisë, projektet, përgjigjet me gojë, prezantimet, kuizet dhe testet (me zgjedhje të shumëfishta, e saktë/ e gabuar, me çifte, po/jo). Ky vlerësim mund të kryhet fare mirë me anë të nxënësve, është vlerësim zhvillues dhe me reagime të menjëhershme. Vlerësimet në klasë janë më të shkurtra, marrin më pak kohë për të shënuar dhe janë të dobishme, sepse jepen reagime të menjëhershme mbi përparimin e nxënësve.

Zhvendosni përgjegjësinë - prezantoni vetëvlerësimin dhe vlerësimin e nxënësit nga nxënësi për të zhvilluar aftësitë e nxënësve për të vlerësuar punën e tyre dhe atë të shokëve të tyre. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësit nga nxënësi rrit sasinë e reflektimit të nxënësve. Sigurisht mësuesi mund të plotësojë vlerësimin. Nuk është e nevojshme të mbahet shënim për çdo vlerësim apo të vendoset notë për çdo vlerësim. *Vlerësimi është hartuar për të përmirësuar përvoja mësimore për ju dhe për nxënësin, jo vetëm për të "akredituar" nxënësit.*

Ndryshime pozitive që sjell vlerësimi bazuar në kompetenca

<i>Për nxënësit:</i>	<i>Për mësuesit:</i>	<i>Për prindërit:</i>
Siguron informacion për pikat e forta dhe mundësitë për zhvillim.	Siguron të dhëna të hollësishme për aspekte të ndryshme të të nxënësit.	Siguron informacion të detajuar dhe specifik për arritjet e fëmijës.
Mbështet dhe nxit procesin e të nxënësit.	Krijon mundësi të gjykojë më mirë për arritjet e nxënësve.	Përfshihen në procesin e të nxënësit të fëmijës.

Lehtëson nxënësit dhe shmang presionin e notës në mënyrë të vazhdueshme.	Lehtëson vëmendjen e mësuesit nga notat e vazhdueshme duke u përqendruar më shumë te të nxënësit e nxënësve.	Krijon më shumë mundësi për mbështetje rreth të nxënësit të fëmijëve të tyre.
Zhbën “mitin” e notës.	Shmang subjektivizmin në vlerësim.	Interesohen më shumë për përparimin e nxënësve në vazhdimësi.
Siguron vetëbesim të nxënësit.	Siguron të dhëna nga burime të ndryshme për të motivuar nxënësin.	Vlerësohen jo vetëm arritjet, por edhe përpjekjet që bëjnë fëmijët e tyre.
Krijon mundësi për vetëvlerësim dhe forma të larmishme vlerësimi.	Organizimi i veprimtarive gjithëpërfshirëse gjatë zhvillimit të mësimin me dy orë të njëpasnjëshme e lehtëson shumë këtë proces vlerësimi.	Prindërit kanë mundësi të japin mendimin e tyre për vlerësimin e fëmijës së tyre.
Motivon zhvillimin e kompetencave të të nxënësit (kompetencave kyçe dhe lëndore).	Nxit rritjen profesionale të mësuesit.	Zhvillimi i kompetencave kyçe aftëson nxënësit edhe në zgjidhjen e situatave në jetën e përditshme.
Bazohet në nivele arritjesh të njëjta për të gjithë.	Mësuesi është transparent dhe objektiv për të gjithë	Bazuar në nivele prindërit ndërgjegjësohen për vlerësimin e fëmijës së tyre.
Zhvillon talente dhe u jep mundësi të gjithë nxënësve të tregojnë aftësitë e tyre.	Siguron gjykime dhe mbështet vendimmarrje mbi bazën e të dhënave të shumta që siguron.	Sigurojnë informacione mi bazën e të dhënave që mësuesi siguron nga burime të ndryshme.
E bën nxënësin më “miqësor” me lëndën.	E bën lëndën më “të dashur” për nxënësin.	E bën shkollën dhe mësuesit më “të pëlqyeshëm” për fëmijët e tyre.

Zhvendosje në “vlerësim”

Nga vlerësimi i fokusuar te ajo që nxënësi nuk di.....	Te vlerësimi i procesit se si nxënësi e ndërton dijen...
Nga përdorimi i rezultateve për të llogaritur notën..	Te përdorimi i rezultateve për të informuar rreth të nxënit..
Nga vlerësimi vetëm i mësuesit.	Te nxënësi që është i përfshirë në vlerësimin e vazhduar të punës së tij dhe të të tjerëve.
Nga gjykimin e punës që mund të dëmtojë motivimin e nxënësit.	Te përshkrimi i punës që fuqizon dhe motivon nxënësin..

IX. KRITERET E HARTIMIT DHE TË VLERËSIMIT TË TESTIT

Një test është një vlerësim formal, përmbledhës, i strukturuar i arritjeve të nxënësve dhe i progresit të nxënësit. Testet janë një aspekt i rëndësishëm i procesit të mësimdhënies - nxënies nëse ata janë të integruar në “rutinën” e klasës dhe nuk trajtohen thjesht si një strategji “përmbledhëse”. Ata u lejojnë nxënësve të monitorojnë progresin e tyre dhe ofron informacion të vlefshëm për mësuesin në planifikimin e mëtejshëm të procesit të mësimdhënies – nxënies. Testet ndihmojnë në nxënien e nxënësve nëse ato janë të lidhura qartë me mësimin dhe rezultatet e të nxënit. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që testet të korrigjohen dhe nxënësve t’u jepet përshtypja për performancën e tyre. Testet e hartuara në klasë zbulojnë rreth njohurive të nxënësve për përmbajtjen dhe për zhvillimin e të menduarit. Përgjithësisht pyetjet e hapura japin informacion më të detajuar në lidhje me aftësitë e nxënësve sesa një pyetje në të cilën ka vetëm një përgjigje.

9.1 Parimet e hartimit të testeve nga mësuesi

Testet lejojnë shumëllojshmëri mënyrash të demonstrimit të aftësive të nxënësve. Prandaj:

- nxënësit duhet të kuptojnë qëllimin dhe vlerën e testit;
- testi duhet të masë arritjen e rezultateve të të nxënit për një kapitull ose periudhë të caktuar;
- duhen dhënë udhëzime të qarta për secilën pjesë të testit;
- pyetjet duhet të ndryshojnë nga më e thjeshta te ajo më komplekse;
- pikët duhet të jepen për çdo pyetje apo rubrikë të testit;

- pyetjet duhet të jenë të llojeve të ndryshme (po/jo, e saktë/e gabuar, me zgjedhje të shumëfishtë, çiftim i elementeve, plotësim i vendeve bosh, zëvendësim i elementeve; përgjigje e zgjeruar, përgjigje e shkurtër etj.,)

Testet duhet:

- të jenë të lehtë për t'u lexuar dhe të ketë hapësirë ndërmjet pyetjeve për të lehtësuar leximin dhe shkrimin;
- të përfshijnë një sërë rezultatesh të nxëni;
- të mund të kryhen nga nxënësit me nevoja të veçanta;
- t'u krijojnë mundësi nxënësve të zgjedhin kërkesat e ushtrimeve në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra;
- të kenë nivele të ndryshme të pyetjeve për të përfshirë mbledhjen, përpunimin dhe zbatimin e informacioneve;
- të llogariten me kohë të mjaftueshme për të përfunduar të gjithë nxënësit;
- të mos ngatërrohen me minitestet të cilat matin rendimentin e orës së mësimi dhe kanë vetëm një kërkesë.

Gjatë ndërtimit të testeve të arritjes për një grup njohurish të lëndës mësuesi duhet të ketë në konsideratë:

- numri i pyetjeve në teste varet nga ajo çfarë do të testohet. ky numër është i ndryshëm kur synohet testimi i përvetësimit të një koncepti, i përvetësimit të një mësimi, i përvetësimit të një kapitulli, i përvetësimit të lëndës të një periudhe, i përvetësimit vjetor të lëndës etj.;
- është mirë që testet të hartohen me pyetje të llojeve të ndryshme; pyetje të strukturuar, me alternativa, pyetje me zgjidhje të shkurtër;
- pyetjet në test është mirë të radhiten sipas shkallës së vështirësisë së tyre;
- numri i pyetjeve të testit varet edhe nga koha në dispozicion, kjo kohë mesatarisht duhet të jetë 45 minuta;
- gjatë hartimit të një testi është shumë e rëndësishme vlefshmëria e pyetjeve të tij (d.m.th. garantimi i asaj që testi në tërësi duhet të vlerësojë ato koncepte, njohuri, aftësi e shprehje që ne i kemi vënë vetes si qëllim të kontrollojmë).

9.2 Hartimi i testit

Hartimi i testit në lëndën e historisë bazohet te bazat metodologjike të hartimit të testeve. Për hartimin e testit ndërmerren hapat e mëposhtëm:

- 1) përcaktimi i listës së koncepteve që do të testohen me peshën përkatëse (% e pikëve që do të zënë secili koncept kryesor në test) si dhe rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave historike;
- 2) Përcaktimi i peshës së niveleve që do të zbatohet në test. Niveli i dytë i arritjes së kompetencave (rekomandohet 40%) përfshin pyetje ku kërkohet që nxënësi të zbatojë një procedurë rutinë, mjaft të ushtruar në klasë. Niveli i tretë i arritjes së kompetencave (rekomandohet 40%) përfshin pyetje ku nxënësit nuk i mjafton të kujtojnë procedura rutinë, as të imitojnë zgjidhje standarde. Ai duhet të ndjehet para një situatë më komplekse, të cilën, sidoqoftë mund ta zgjidhë duke kombinuar njohuritë që disponon. Niveli i katërt i arritjes së kompetencave (rekomandohet 20%) përfshin pyetje ku nxënësi gjykon, zgjidh, jep mendim, vlerëson, harton duke vënë në dispozicion njohuritë e tij;
- 3) Ndërton tabelën e specifikimit (Tabela e Blue –Printit);

Konceptet	Përqindja = Pikët	Rezultatet e të nxënësve	Niveli II i arritjes së kompetencave	Niveli III i arritjes së kompetencave	Niveli IV i arritjes së kompetencave
.....					
Pikët total të testit	100% = ... pikë		30% - 40% = ... pikë Ose 35%	40% - 45% = ... pikë Ose 40%	20% - 25% = ... pikë Ose 25%

Tabela na ndihmon për të marrë këto informacione për përmbajtjen e testit:

- A përmban testi pyetje për të gjitha rezultatet e të nxënësve që përmban programi?
- Sa pyetje duhet të përmbajë testi për secilin rezultat të nxënësi?
- A është përcaktuar një ekuilibër në përzgjedhjen e pyetjeve që ka testi dhe njohuritë brenda temave mësimore?
- A është specifikuar secili rezultat i të nxënësve sipas tre niveleve të arritjeve të kompetencave lëndore?

- 4) hartimi i pyetjeve të testit;

5) hartimi i skemës së vlerësimit (Bazuar ne teoremën e Gausit).

- Skema e vlerësimit u vjen në ndihmë mësuesve për të bërë vlerësimin e standardizuar për të gjithë nxënësit. Skema shmang çdo lloj fiktiviteti gjatë korrigjimit të testit.
- Vendosja e pikëve për çdo kërkesë bëhet mbi bazën e çdo hapi që nxënësi ndërmerr gjatë zgjidhjes së kërkesës, të cilat pasqyroheshin qartë në skemën e qortimit.
- Vlerësimi me pikë i kërkesave që përmban testi është pjesa më e rëndësishme e hartimit të tij. Në vlerësimin përfundimtar merret parasysh dallimi në vlerësimin e nxënësit, i cili përcaktohet nga niveli i arritjeve.
- Një faktor mjaft i rëndësishëm në vlerësimin përfundimtar është hartimi i saktë i skemës së pikëzimit të testit dhe konvertimi i pikëve në notë sipas teoremës së Gausit.

Hartimi i skemës së vlerësimit (skema e qortimit)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikë	0-7	8-14	15-20	21-25	26-30	31 - 35	36 - 40

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Përqindjet	<25%	25-38%	39-51%	52-64%	65-77%	78-90%	91-100%

Skema më e saktë (teorema e Gausit)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikë	0-8 +8	9-15 +6	16-22 +6	23-28 +5	29-33 +4	34-37 +3	38- 40 +2

Tabela e vlerësimit për një test me 40 pikë

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikë	0-7	8-14	15-20	21-25	26-30	31 - 35	36 - 40

9.3 Llojet e pyetjeve që hartohen në teste

Llojet e pyetjeve që mund të përdoren në teste mund të paraqiten si më poshtë:

1. *Pyetje me alternativa (me zgjedhje të shumëfishtë).*

- Një pyetje me zgjedhje të shumëfishtë përbëhet nga dy pjesë: nga trangu dhe përgjigjet alternative ndër të cilat dallohet përgjigja e vetme e saktë.
- Alternativat duhet të vendosen vertikalisht pas përmbajtjes së pyetjes, në përputhje me rendin alfabetik.
- Nuk duhet të përdoren alternativa që përplasen me njëra - tjetrën.
- Pyetjet ndërtohen në përgjithësi me 4 alternativa.
- Alternativat duhet të kenë gjatësi të njëjtë.
- Alternativat duhet të jenë homogjene dhe t'i referohen të njëjtës kategori.
- Në alternativa nuk duhet të ketë mbivendosje të dhënash apo intervalesh kohore.
- Vetëm një alternativë është e saktë.
- Pyetja me alternativë vlerësohet me një pikë.
- Pyetjet me alternativa shmangin në shkallë të lartë subjektivitetin në pikëzim.

Shembull:

Filozofi anglez Xhon Lok argumentonte që jeta, liria dhe prona janë:

- A) të drejta natyrale që do të duheshin të mbroheshin nga qeverisja;
- B) të drejta politike që duhet të jepen sipas përcaktimit me ligj;
- C) të drejta ekonomike të fituara në një sistem kapitalist;
- D) të drejta shoqërore të garantuara nga klasa në pushtet.

2. *Pyetje të strukturuar*

- Strukturimi i një pyetjeje (situate) është zbërthimi i saj në elemente përbërëse me karakteristikat kryesore që meritojnë të studiohen.
- Shkalla me të cilën mësuesit do të zbërthejnë një pyetje (ose situatë) varet nga natyra dhe kompleksiteti i saj, nga niveli i të mësuarit dhe aftësitë individuale të nxënësve.
- Kur pyetja (situata) është shumë komplekse dhe aftësitë nuk janë të larta duhet të rritet shkalla e strukturimit.
- Një nga funksionet e pyetjeve të strukturuar është që ta mundësojnë lidhjen midis mësimdhënies, të nxënësve dhe vlerësimit të arritjes.

- Në një pyetje të strukturuar nxënësit i kërkohet të njihet me informacionin që jepet në trungun e përbashkët të pyetjes dhe më pas t'u përgjigjet një sërë kërkesash që lidhen me përmbajtjen e këtij trangu dhe që testojnë në mënyrë progresive njohuritë e nxënësit rreth çështjes.
- Si rregull niveli i vështirësisë së këtyre pyetjeve vjen duke u rritur.
- Pyetjet duhet të jenë të pavarura nga njëra tjetra dhe përgjigjja e saktë për një pyetje nuk duhet të varet nga përgjigja e saktë e pyetjes paraardhëse.

Shembull:

Dyndjet sllave në gadishullin e Ballkanit patën pasoja të rënda për popullsitë autoktone të kësaj treve. Megjithatë, një pjesë e rëndësishme e popullsisë ilire ruajti të paprekur karakterin e vet etnik dhe kompaktësinë përballë këtij rreziku.

Listoni 3 arsye përse në Ilirinë e Jugut popullsia ilire i rezistoi asimilimit sllav:

- a).....
- b).....
- c).....

3. Pyetje të hapura

- Këto lloj pyetjesh mund të kenë disa përgjigje të sugjeruara nga nxënësit. Në këtë rast vlerësohen argumentet që jep nxënësi dhe saktësia në arsyetimin e mendimeve dhe veprimeve përkatëse.

Shembull:

Me ardhjen në Shqipëri të ushtrisë gjermane, nacionalistët u ndanë në dy grupime me qëndrim të ndryshëm ndaj këtij elementi të ri që u shfaq pas kapitullimit të Italisë fashiste.

Evidentoni arsyet përse një pjesë e grupimeve politike nuk pranoi të hynte në veprime luftarake me gjermanët:

4. Ese

Shembull :

Ese argumentuese - Vlerëso një personazh historik që të frymëzon.

5. Pyetje mbështetur mbi dokumente

- Këto pyetje modelohen mbështetur në interpretimin e dokumenteve historike. Këto dokumente mund të jenë të formave të ndryshme: dokumente të shkruara, audio-vizuale etj. Ato do të shërbejnë si nxitje në përgjigjen e nxënësve.

Shembull:

- Me çfarë situatë ekonomike i identifikoni fotot e mëposhtme?
- Analizoni shkaqet dhe masat e ndërmarra për tejkalimin e efekteve të saj duke e ilustruar me ndonjë shembull konkret nga njohuritë tuaja.



Në një prej tabelave shkruhet: “Kërkohet një punë e pranueshme nga një njeri i mirë, veteran lufte, që paguan kredi për shtëpinë, me arsim të lartë...”



Ofrohet pa pagesë supë, kafe dhe petulla për të papunët

Shembull 1. Testi përmbledhës periudha e tretë; 45 minuta; Klasa XI

Tematika	Tema	Konceptet kyçe
- V. Shqiptarët dhe Lufta e Dytë Botërore 1939 – 1945 (vazhdim) - Shqipëria gjatë regjimit komunist (1945-1990) - Rënia e regjimit komunist. Fitorja e demokracisë	- Çlirimi i vendit dhe pasojat e luftës (maj-nëntor 1944) - Vendosja e regjimit komunist - Opozita shqiptare kundër vendosjes së regjimit komunist - socialiste dhe tiparet e saj - Arsimi, kultura, shkenca, artet gjatë viteve 1945-1990. - Marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë - Tipare të represionit komunist - Kriza e regjimit komunist - Kosova dhe shqiptarët në Republikën e Jugosllavisë (1945–1989) - Lëvizja studentore e dhjetorit (1990) dhe rrëzimi i regjimit komunist. - Tranzicioni demokratik në Shqipëri (1990-2014) - Procesi i integritetit euroatlantik i Shqipërisë (1990-2014) - Shpallja e Pavarësisë dhe ngritja e shtetit demokratik të Kosovës (1990-2014)	- çlirim; - dëme lufte; - dëshmorë; - diktaturë e proletariatit; - kryengritje antikomuniste, - parti-shtet, - shtetëzim, - ekonomi e centralizuar, - luftë klasash, - reforma agrare, - kolektivizim, - pronë shtetërore dhe kooperativiste, - kult i individit, - propagandë, - disident, - ekonomi e centralizuar dhe e planifikuar, - shkelje e të drejtave themelore politike dhe sociale të njeriut, - ateizëm, - ideologjizimi komunist - kriza e regjimit komunist, - demokraci, - pluralizëm, - zgjedhje të lira, - ekonomi e lirë e tregut, - tranzicion, - integrimi euroatlantik, - Pavarësia e Kosovës

Përcaktimi i rezultateve kryesore të të nxënit që do të testohen dhe grupimi i tyre sipas niveleve:

Rezultatet e të nxënit për njohuritë/ aftësitë që do të testohen	Grupimi i rezultateve të të nxënit sipas niveleve të arritjes
• analizon zhvillimet politike dhe ushtarake në prag të çlirimit të vendit • përshkruan procesin e vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri; • evidenton masat ekonomike dhe politike që mori regjimi komunist në Shqipëri gjatë viteve 1944-1948 duke gjykuar mbi pasojat e tyre; • shpjegon tiparet e qëndresës së forcave demokratike dhe antikomuniste ndaj regjimit komunist në Shqipëri; • përcakton diktaturën e proletariatit dhe luftën e klasave si tipar kryesor ideologjik të regjimit komunist; • shpjegon politikat ekonomike të shtetit shqiptar, duke evidentuar shtetëzimin, centralizimin, planifikimin, industrializimin dhe kolektivizimin e bujqësisë si tiparet kryesore të tij; • gjykon mbi pasojat që patën politikat ekonomike në jetën e shqiptarëve; • përshkruan ndryshimet që pësoi shoqëria shqiptare në fushën e arsimit, artit, kulturës, fesë, shëndetësisë, rolit të gruas dhe jetës së përditshme;	Niveli 2 (nota 5-6) • shpjegon pasojat e Luftës II Botërore në Shqipëri; • vë në dukje qëndresën e armatosur të shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe të rënët në luftë; • evidenton dhunën e ushtruar nga organet shtetërore ndaj opozitës demokratike dhe antikomuniste; • përshkruan ndryshimet që pësoi shoqëria shqiptare në fushën e arsimit, artit, kulturës, fesë, shëndetësisë, rolit të gruas dhe jetës së përditshme; • liston format dhe metodat e ushtrimit të represionit nga shteti i diktaturës së proletariatit; • tregon drejtimit kryesore të politikës së jashtme të shtetit shqiptar; • identifikon disa nga tiparet e krizës ekonomike dhe përpjekjet e drejtuesve komunistë për të lehtësuar gjendjen; • përshkruan disa nga momentet kryesore të shprehjes së pakënaqësisë popullore kundër diktaturës komuniste; • përshkruan manifestimet e pakënaqësisë popullore që kulmuan me lëvizjen e dhjetorit 1990;

• evidenton ideologjizimin e arsimit, artit dhe kulturës shqiptare si pjesë të procesit të krijimit të “njeriut të ri”; • shpjegon pasojat që pati lufta e klasave dhe shkelja e të drejtave të njeriut gjatë regjimit komunist; • liston format dhe metodat e ushtrimit të represionit nga shteti i diktaturës së proletariatit; • shpjegon pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Paris; • tregon drejtimet kryesore të politikës së jashtme të shtetit shqiptar; • përshkruan veçoritë e marrëdhënieve ndërshtetërore Shqipëri – Jugosllavi, duke evidentuar faktorët që çuan në prishjen e këtyre marrëdhënieve dhe pasojat; • shpjegon shkaqet e orientimit të ri politik të qeverisë shqiptare drejt BRSS-së pas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë; • përshkruan marrëdhëniet me BRSS pas ardhjes së Hrushovit në krye të shtetit sovjetik; • evidenton faktorët që çuan në prishjen e marrëdhënieve me BRSS-në dhe pasojat; • shpjegon shkaqet e orientimit të ri politik të qeverisë shqiptare drejt Republikës Popullore të Kinës;	• përshkruan gjendjen ekonomike, politike dhe qëndresën e shqiptarëve në Jugosllavi 1945-1968; • tregon sfidat e shtetit shqiptar në rrugën e integritetit euro-atlantik; Niveli 3 (nota 7-8) • evidenton masat ekonomike dhe politike që mori regjimi komunist në Shqipëri gjatë viteve 1944-1948 duke gjykuar mbi pasojat e tyre; • shpjegon tiparet e qëndresës së forcave demokratike dhe antikomuniste ndaj regjimit komunist në Shqipëri; • shpjegon politikat ekonomike të shtetit shqiptar, duke evidentuar shtetëzimin, centralizimin, planifikimin, industrializimin dhe kolektivizimin e bujqësisë si tiparet kryesore të saj; • tregon drejtimet kryesore të politikës së jashtme të shtetit shqiptar; • përshkruan veçoritë e marrëdhënieve ndërshtetërore Shqipëri – Jugosllavi,
---	---

• shpjegon tiparet e marrëdhënieve të qeverisë shqiptare me Kinën dhe ndikimin e tyre në shoqërinë shqiptare; • shpjegon shkaqet që çuan në prishjen e këtyre marrëdhënieve dhe pasojat e tyre. • përcakton veçoritë e politikës së qeverisë komuniste shqiptare, të cilat çuan në izolimin e plotë ndërkombëtar të vendit; • evidenton arsyet që çuan në krizën ekonomike dhe politike të shoqërisë shqiptare në gjysmën e dytë të viteve '80; • identifikon disa nga tiparet e krizës ekonomike dhe përpjekjet e drejtuesve komunistë për të lehtësuar gjendjen; • përshkruan disa nga momentet kryesore të shprehjes së pakënaqësisë popullore kundër diktaturës komuniste; • përshkruan gjendjen ekonomike, politike dhe qëndresën e shqiptarëve në Jugosllavi 1945-1968; • vlerëson Kushtetutën e vitit 1974 për Kosovën; • përshkruan rrugën e rivendosjes së autoritetit serb në Kosovë dhe pasojat e tij në pozitën e popullsisë shqiptare në Jugosllavi; • shqyrton aspekte të jetës së përditshme në Kosovë; • përshkruan manifestimet e pakënaqësisë popullore që kulmuan me lëvizjen e dhjetorit 1990;	• shpjegon tiparet e marrëdhënieve të qeverisë shqiptare me Kinën dhe ndikimin e tyre në shoqërinë shqiptare; • analizon veçoritë e politikës së qeverisë komuniste shqiptare, të cilat çuan në izolimin e plotë ndërkombëtar të vendit; • shpjegon rrugën e rivendosjes së autoritetit serb në Kosovë dhe pasojat e tij në pozitën e popullsisë shqiptare në Jugosllavi; • tregon sfidat e shtetit shqiptar në rrugën e integritetit euro-atlantik; • shpjegon faktorët që ndikuan në procesin e pavarësimit të Kosovës ;
	Niveli 4 (nota 9-10) • analizon zhvillimet politike dhe ushtarake në prag të çlirimit të vendit • shpjegon tiparet e qëndresës së forcave demokratike dhe antikomuniste ndaj regjimit komunist në Shqipëri; • përcakton diktaturën e proletariatit dhe luftën e klasave si tipar kryesor ideologjik të regjimit komunist; • shpjegon politikën ekonomike të shtetit shqiptar, duke evidentuar shtetëzimin, centralizimin, planifikimin, industrializimin dhe kolektivizimin e bujqësisë si tiparet kryesore të saj; • gjykon mbi pasojat që patën politikën ekonomike në jetën e shqiptarëve; • shpjegon arsyet që çuan në prishjen e këtyre marrëdhënieve dhe pasojat;

• përshkruan rrugën që çoi në vendosjen e pluralizmit politik dhe ndërrimin e pushteteve (1991-1992); • përshkruan veçoritë e sistemit të ri politik ekonomik e shoqëror; • krahason aspekte të jetës së përditshme të Shqipërisë me aspekte të jetës së përditshme në Evropë; • tregon sfidat e shtetit shqiptar në rrugën e integritit euro-atlantik; • shpjegon faktorët që ndikuan në procesin e pavarësimit të Kosovës ; • vlerëson rolin që patën ndërkombëtarët në këtë proces; • vlerëson rëndësinë që pati shpallja e Pavarësisë për Kosovën;	• shpjegon shkaqet që çuan në prishjen e marrëdhënieve shqiptaro – kineze dhe pasojat e tyre. • gjykon arsyet që çuan në krizën ekonomike dhe politike të shoqërisë shqiptare në gjysmën e dytë të viteve '80; • vlerëson Kushtetutën e vitit 1974 për Kosovën; • krahason aspekte të jetës së përditshme të Shqipërisë me aspekte të jetës së përditshme në Evropë; • vlerëson rëndësinë që pati shpallja e Pavarësisë për Kosovën;
--	--

Përcaktimi i peshave në përqindje të çdo tematikave, nëntematikave dhe temave që përmban testi në matricë dhe niveleve të arritjes:

Ndërtimi i tabelës së specifikimit

- Mësuesi duhet të përcaktojë numrin e kërkesave që duhet të përmbajë testi në përputhje me kohën e realizimit të tij.
- Koha e plotë duhet të jetë 45 minuta, pra 1 orë mësimore.
- Testi përfshin tematikat: Shqiptarët dhe Lufta e Dytë Botërore 1939 – 1945 (një temë), Shqipëria gjatë regjimit komunist (1945-1990), Rënia e regjimit komunist. Fitorja e demokracisë
- Testi përfshin 16 pyetje.
- Duke pasur parasysh nivelet e arritjeve të rezultateve të nxënësve sipas kompetencave lëndore dhe peshat e përcaktuara sipas niveleve, ndërtojmë tabelën e Blueprintit:
- për Nivelin 2, testi përmban 12 pikë, pra 40% të pikëve të përgjithshme të tij;
- për Nivelin 3, testi përmban 12 kërkesa, pra 40% të pikëve të përgjithshme të tij;
- për Nivelin 4, testi përmban 6 kërkesa, pra 20% të pikëve të përgjithshme të tij.

Temat	Rezultatet e të nxënit	Peshat në %	Pikët	N.2 40%	N. 3 40%	N. 4 20%
Shqiptarët dhe Lufta e Dytë Botërore		8%	2			
Çlirimi i vendit dhe pasojat e luftës (maj-nëntor 1944)		8%	2	1	1	0
Shqipëria gjatë regjimit komunist (1945-1990)		66%	20			
Vendosja e regjimit komunist		10%	3	0	3	0
Opozita shqiptare kundër vendosjes së regjimit komunist		3%	1	1	0	0
Ekonomia socialiste dhe tiparet e saj		3%	1	1	0	0
Arsimi, kultura, shkenca, artet gjatë viteve 1945-1990.		10%	3	3	0	0
Marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë		20%	6	0	2	4
Tipare të represionit komunist		7%	2	0	0	2
Kriza e regjimit komunist		10%	3	0	3	0
Kosova dhe shqiptarët në Republikën e Jugosllavisë (1945–1989)		3%	1	1	0	0
Rënia e regjimit komunist. Fitorja e demokracisë		26%	8			

Lëvizja studentore e dhjetorit (1990) dhe rrëzimi i regjimit komunist.		7%	2	0	2	0
Tranzicioni demokratik në Shqipëri (1990-2014)		13%	4	1+3	0	0
Procesi i integritetit euroatlantik të Shqipërisë (1990-2014)		3%	1	0	1	0
Shpallja e Pavarësisë dhe ngritja e shtetit demokratik të Kosovës (1990-2014)		3%	1	1	0	0
Totali		100%	30	12	12	6

Shembull: Test periudha e tretë; Klasa 11

1. Cili prej pohimeve i takon Mbledhjes II të Këshillit ANC në Berat? (1 pikë)

- U ndalua kthimi i mbretit Zog në Shqipëri
- Këshilli i Përgjithshëm ANC të shndërrohej në qeveri të përkohshme
- U vendosën gradat në ushtri
- Forma e regjimit të vendosej pas lufte me votë popullore.

2. Kur u çlirua Tirana nga pushtuesit nazi – fashistë? (1 pikë)

- 15 nëntor 1944
- 16 nëntor 1944
- 17 nëntor 1944
- 19 nëntor 1944

3. Jepni tri rrugë për krijimin e bazës ekonomike të sistemit socialist? (3 pikë)

.....

.....

.....

4. *Cila ngjarje ndërkombëtare shërbeu si frymëzim për ngjarjet e Konferencës së Tiranës në vitin 1956?* (1 pikë)

- A) Ndërtimi i Murit të Berlinit
- B) Kriza e raketave në Kubë
- C) Kongresi XX i Partisë Komuniste të BS
- D) Pranvera e Pragës

5. *Nga çfarë karakterizohej modeli socialist në ekonomi?* (1 pikë)

- A) eliminimi i pronës private
- B) planifikimi i ekonomisë
- C) centralizimi shtetëror
- D) të gjitha

6. *Shpjegoni tiparet e arsimit shqiptar sipas ligjit për Reformën Arsimore të gushtit 1946.*

(3 pikë)

.....
.....
.....

7. *Lexoni dokumentet e mëposhtme dhe përgjigjuni pyetjeve në vazhdim.* (4 pikë)

“Përmbajtja e traktatit është që të dy vendet të koordinojnë planet e tyre ekonomike në baza të përbashkëta dhe për këtë arsye do të ngrihen organe koordinimi. Njësia e vlerës së monedhës do të jetë e barabartë për të dyja vendet, prandaj Republika shqiptare duhet të shpjerë vlerën e njësisë së monedhës baras me dinarin.

Qeveria e R.F.P. të Jugosllavisë angazhohet në këtë traktat të furnizojë Shqipërinë me plaçkë tregu dhe material të caktuar në marrëveshje, që parashikohet sipas koordinimit të planeve për të mbajtur vlerën e lekut baras me dinarin.

Të dyja qeveritë angazhohen që brenda një muaji të zhduken kufijtë doganorë dhe doganat në mes të dy vendeve, duke krijuar një territor doganor mik, në krye të së cilit do të ketë një komision shqiptaro-jugosllav.”

(Nga “Traktati mbi koordinimin e planeve ekonomike, bashkimin doganor dhe barazimin e monedhave midis R.P. të Shqipërisë dhe R.F.P. të Jugosllavisë”, nënshkruar në Beograd më 27 nëntor 1946.)

- a) Duke u mbështetur në paragrafët mbi “Traktatin ekonomik”, shpjegoni natyrën e marrëdhënieve ekonomike shqiptaro – jugosllave në vitet 1945 - 1948.
- b) Jepni dy argumente nëse këto marrëveshje ishin apo jo në favor të ekonomisë shqiptare.

8. Identifikoni dy shkaqe të prishjes së marrëdhënieve shqiptaro – kineze. (2 pikë)

.....

.....

9. Interpretoni dokumentet e mëposhtme dhe nxirrni përfundimet tuaja në lidhje me qëndrimin e shtetit komunist ndaj besimeve fetare. (2 pikë)

Nga kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë e vitit 1946

Neni 18

Të gjithë shtetasve u garantohet liria e ndërgjegjes dhe e besimit.

Kisha është e ndarë nga shteti.

Komunitetet fetare janë të lira në çështjet e tyre të besimit si edhe në ushtrimin dhe praktikimin e jashtëm të tyre...

...shteti mund të ndihmojë materialisht komunitetet fetare.

Nga kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë e vitit 1976

Neni 37

Shteti nuk njeh asnjë fe dhe përkrah e zhvillon propagandën ateiste për të rrënjosur te njerëzit botëkuptimin materialist shkencor.

10. Shpjego tri arsye të krizës së sistemit socialist në fund të viteve '80: (3 pikë)

.....

.....

.....

11. Evidento statusin juridik që mori Kosova me kushtetutën e vitit 1974 (1 pikë)

- A) Rajon autonom në kuadër të Serbisë
- B) Republikë brenda Jugosllavisë
- C) Krahinë autonome në kuadër të Serbisë
- D) Shtet i pavarur

12. Zgjedhjet e para pluraliste të 31 marsit 1991, nuk sollën ndërrimin e pushtetit.
Pakënaqësia e popullit u thellua më shumë. (2 pikë)

Identifikoni arsyet e rritjes së pakënaqësisë në popull.

.....

.....

13. Jepni tri elementë të programit të qeverisë Berisha pas fitores së PD-së në vitin 2005. (3 pikë)

.....

.....

.....

14. Cila nga arsyet e mëposhtme ishte shkak për ngjarjet e vitit 1997 në Shqipëri? (1 pikë)

- A) Pretendimet e opozitës për zgjedhje të parregullta
- B) Hapja e depove ushtarake dhe armatosja e popullit
- C) Rënia e firmave piramidale
- D) Të gjitha

15. Identifikoni statusin aktual të Shqipërisë në raport me Bashkimin Evropian: (1 pikë)

.....

16. Cila marrëveshje nuk u nënshkrua nga Serbia pas së cilës nisën sulmet e NATO-s mbi këtë të fundit? (1 pikë)

- A) Marrëveshja e Londrës
- B) Marrëveshja e Rambujesë
- C) Pakti i Stabilitetit
- D) Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit

Tabela e pikëve

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-11	12-15	16-19	20-23	24-27	28-30

Pikët për secilën pyetje

Tema	Pyetja	Pikë
5.4	Evidenton një prej vendimeve të mbledhjes së dytë të KANÇ.	1 pikë
5.4	Identifikon datën e rëndësishme të çlirimit të Tiranës.	1 pikë
6.1	Tregon tre nga rrugët që u përdorën në krijimin e bazës ekonomike pas vendosjes së regjimit komunist.	3 pikë
6.2	Identifikon lidhjen mes ngjarjeve të Konferencës së Tiranës dhe atyre ndërkombëtare.	1 pikë
6.3	Tregon tiparet kryesore të sistemit ekonomik socialist.	1 pikë
6.4	Shpjegon ndryshimet në sistemin arsimor pas aprovimit të Ligjit të Reformës Arsimore.	3 pikë
6.5	Analizon marrëdhëniet ekonomike shqiptaro-jugosllave, shpjegon nëse ato ishin në favor të kujt ishin ato.	4 pikë
6.5	Identifikon dy nga arsyet e prishjes së marrëdhënieve shqiptaro-kineze.	2 pikë
6.6	Duke interpretuar dokumentin, shpjegon qëndrimin e regjimit komunist ndaj besimeve fetare.	2 pikë

6.8	Shpjegon tri arsye të krizës së sistemit komunist në Shqipëri.	3 pikë
6.10	Evidenton statusin juridik të Kosovës sipas Kushtetutës së vitit 1974.	1 pikë
7.1	Vë në dukje arsyet e pakënaqësisë popullore në vitin 1991.	2 pikë
7.2	Evidenton tre elemente të programit të qeverisë Berisha pas fitores së PD-së në vitin 2005.	3 pikë
7.2	Identifikon një nga shkaqet që çuan në ngjarjet e vitit 1997.	1 pikë
7.3	Tregon statusin e Shqipërisë në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Evropian.	1 pikë
7.4	Identifikon ngjarjen që u dha udhë bombardimeve të NATOS-s mbi Serbi.	1 pikë

9.4 Detyra përmbledhëse

Për vlerësimin me detyrë përmbledhëse në lëndën e historisë, si pjesë e fushës “Shoqëria dhe mjedisi”, mund të përdoret detyrë e tipit veprimtari praktike, ese etj. Përmes saj, mësuesi vlerëson grupin e rezultateve të të nxënitorit të periudhës që ka veçuar si më të rëndësishme, në varësi të rezultateve të të nxënitorit që ka planifikuar të përmbushë për atë periudhë.

Shembull: Historia 10

Veprimtari praktike: Monarkët e iluminuar në Evropë

Mësuesi mund të testojë njohuritë e nxënitorit në lidhje me:

- evolucionin e koncepteve dhe modelit qeverisës nga Mesjeta në periudhën moderne;
- bazat ideologjike të këtij evolucioni (lidhja me idetë iluministe);
- figurat historike më përfaqësuese të periudhës dhe ndonjë konkretizim të kontakteve mes tyre (nga kërkimet e nxënitorit);
- listime reformave të ndryshme dhe shpjegimin e thelbit të atyre më kryesoreve;
- për ndonjë monark apo vend mund të stimulohet nxënitorit që të gjejë reflektim të politikave të tij në ditët, p.sh. prirja e Pjetrit të Madh drejt Evropës perëndimore vs. qëndrimit preferencial të Rusisë së sotme drejt Lindjes (Azisë);
- lidhja shkak-pasojë mes monarkut dhe pushtetit si kufizim natyral i veprimtarisë së tij.

Në këtë mënyrë mësuesi vlerëson jo vetëm për njohuritë e fituara, por dhe për kompetencat dhe konceptet kyçe historike si kërkimi; përdorimi i burimeve, kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia, interpretimi historik, analiza shkak - pasojë.

Mësuesi sipas temave që ka paracaktuar paraprakisht të testojë i rendit ato në mënyrë të çrregullt. Nga nxënësi kërkon:

- rendit ngjarjet, faktet, figurat dhe zhvillimet historike sipas kronologjisë;
- rendit ngjarjet, faktet, figurat dhe zhvillimet historike sipas rëndësisë historike të ngjarjes.

Nxënësit në këtë mënyrë vlerësohen për konceptet kyçe historike si kronologjia dhe rëndësia historike si dhe kompetencat e lëndës.

Shembull – Historia 10

Temat:

Spanja dhe Portugalia: shtetet e para koloniale

Revolucioni Francez i shekullit XVIII

Bashkimi i Italisë

Lufta për pavarësi dhe Lufta Civile në Amerikën Veriore

Bashkimi i Gjermanisë

Epoka e Napoleonit dhe epoka e restaurimit

Temat e mësipërme mund të përdoren në kombinim për të testuar njohuritë e nxënësit lidhur me:

- kronologjinë e ndodhjes;
- vendosjen në referencë e figurave më përfaqësuese historike me ngjarjet respektive;
- kronologjinë se si mund të kalohet në eksplorimin e lidhjeve mes ngjarjeve historike të cituara më sipër në aspektin ideor, konkret, figura historike prezentë në më shumë se një prej tyre etj.
- mund të gjykohet mbi dhënien e stimujve për analiza krahasuese mes ngjarjeve të mësipërme historike, por edhe personazheve të varësi të nivelit dhe pritshmërisë së nxënësit dhe mësuesit (p.sh:revolucioni amerikan vs. revolucioni francez, apo figura e Xhorxh Washingtonit vs. Napoleon Bonapartit)

Shembull – Historia 10

Tema: Monarkia absolute në Francë

Nxënësit mund t'i jepet materiali "Grimcë historike" dhe pasi ta lexojë, mësuesi nis të testojë njohuritë dhe interpretimin personal të nxënësit në lidhje me tiparet e qeverisjes absolutiste të Luigjit XIV.

Gjithashtu, testimi mund të thellohet drejt lidhjes mes stilit qeverisës së Luigjit XIV (luksi, shpenzimet e shfrenuara dhe zbrazja e buxhetit) dhe ngjarjeve të mëvonshme historike në Francë (revolucion i francez).

Tema: Bashkimi i Italisë

Nxënësit i jepet për lexim pasazhi i mëposhtëm nga teksti mësimor:

Xhuzepe Macini (Giuseppe Mazzini) ishte krijues i grupit të quajtur "Italia e re". Ai u përpoq t'u kujtonte italianëve lavdinë e shkuar të historisë së tyre. Programi i tij përmbledhej në formulën që e përcaktonte Italinë si "një të vetme, të pavarur, të lirë dhe republikane". Mendimi i tij politik mori gradualisht përmasat e një besimi fetar, humanist dhe edukues kombëtar, i përfshirë në frymën elirisë.

Në këtë kontekst, nxënësi mund të pyetet lidhur me:

- rrymat e evidentuara në procesin e bashkimit të Italisë;
- interpretimin e tij lidhur me diferencën mes programeve politike dhe vizionit të patriotëve italianë dhe realizimit konkret të bashkimit si proces.

Duke cituar pasazhe të tjera që lidhen me ekspeditën e Garibaldit, mund të përdoren për të testuar njohuritë e nxënësit në lidhje me rrugët e ndjekura për bashkimin e Italisë.

Në një kontekst ndërtematik, një qasje që vjen natyrale do të ishte gjetja e pikave të përbashkëta dhe të veçanta të proceseve të bashkimit të Italisë dhe Gjermanisë.

Ide të tjera për detyra përmbledhëse

1. Për një grup temash të caktuara mësuesi i kërkon nxënësit të përdorë tekstin si burim informacioni për të kërkuar dhe gjetur në tekst konceptet dhe termat kyçe historike dhe të shpjegojë dy prej tyre. Pasi nxënësi ti ketë gjetur në tekst konceptet kyçe mësuesi vendos së kë koncept do shpjegojë nxënësi.
2. Për një temë të caktuar mësuesi i kërkon nxënësit të shpjegojë shkaqet dhe të analizojë pasojat e kësaj ngjarje historike.
3. Evidenton për një periudhë të caktuar historike ngjarjet më të rëndësishme historike dhe ato figura të cilat kontribuan në ndryshimet e kohës.

4. Mësuesi jep një foto, tablo, hartë apo ilustrim nga teksti për temat e përcaktuara për testim dhe i kërkon nxënësit:
- të interpretojë tablonë, foton, hartën historike etj. për ngjarje, fakte apo dukuri historike të përfshira në to;
 - hartimin e një eseje

Për të gjitha modelet e mësipërme testohet dhe vlerësohet nga mësuesi jo vetëm njohuria, por dhe kompetencat dhe konceptet kyçe historike të nxënësit.

Shembull – Historia 11

Ese: Hebrenjtë dhe shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore

Shënim: Për një vlerësim sa më objektiv të një detyre në formë eseje, mësuesit sugjerohet të mbajnë parasysh kriteret e mëposhtme:

Kriteri I: Organizimi dhe struktura e esesë

Struktura e esesë respekton këto elemente:

- hyrjen - zhvillimin – përfundimin;
- organizimin e esesë, ku shfrytëzohen teknika të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri).

Kriteri II: Analiza

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi shkruan një ese në të cilën:

- argumenton idetë e tij për temën e dhënë;
- mban qartë një pozicion të dukshëm në argumentet e dhëna;
- përdor shembuj nga historia;
- mbështetet në argumente bindëse për përgjigjen e dhënë;
- ka qartësi mendimi.

Kriteri III: Stili dhe origjinaliteti

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të qartë për atë që do të shprehë;
- shprehet me një gjuhë të saktë dhe pa huazime;
- përdor saktë dhe në vendin e duhur termat historik;
- paraqet stil origjinal.

Kriteri IV: Aspekti kronologjik

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- ndjek në mënyrë kronologjike ngjarjet që lidhen me tematikën e esesë;
- përpiqet të përshtatë idetë e tij me kronologjinë e ngjarjeve, duke shmangur një kronikë të thjeshtë historike, por duke e përdorur kronologjinë në funksion të argumenteve të esesë